REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
ALBANIAN UNIVERSITY

STUDIM SHKENCOR I PROJEKTIT

"Vlerësimi i ekspozimit të ndotjes së ajrit të brendshëm shkollat 9-vjeçare në Shqipëri"

Financuar nga AKKSHI në kuadër të projektit PKKZH 2024

Nilena Eriksen
Erda Qorri
Elida Mataj
Rozana Troja
Luljeta Pinguli
Ilirjana Boci
Laura Shabani
Rialda Xhizdari
Ivana Sulaj

Tiranë,
Qershor, 2026

PËRMBAJTJA

HYRJE	10
QËLLIMI I STUDIMIT	12
METODOLOGJIA E STUDIMIT	13
Përzgjedhja e kampionit të studimit	13
Instrumentet e përdorura në studim	14
Marrja e kampioneve të ajrit dhe analiza mikrobiologjike	14
Trajtimi dhe analiza e të dhënave	15
REZULTATET	15
Rezultatet për shkollat e Korcës	84
Rezultatet për shkollat e Vlorës	94
Rezultatet për shkollat e Malësisë së Madhe	108
Rezultatet për shkollat e Kukësit	118
Rezultatet për shkollat e Fierit	123
Rezultatet për shkollat e Tiranës	127
Rezultatet për shkollat e Kavajës	141
DISKUTIMI	143
PËRFUNDIME	151
REKOMANDIME	153
LITERATURA	154

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Karakteristikat strukturore dhe menaxheriale të shkollave të përfshira në vlerësim

Tabela 2. Përbërja e grupmoshave të nxënësve dhe prezenca e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike në shkolla

Tabela 3. Karakteristikat infrastrukturore të ndërtesave shkollore

Tabela 4. Sipërfaqja totale e objekteve shkollore sipas planimetrisë së ndërtesës

Tabela 5. Gjendja e infrastrukturës së shkollave dhe ndikimi i saj në kushte mjedisore

Tabela 6. Gjendja dhe kushtet e tualeteve në shkolla

Tabela 7. Shpërndarja e vendndodhjes së ndërtesave dhe burimet e mundshme afër ndotjes së ajrit në zonat e studiuara

Tabela 8. Shpërndarja e llojit të hapësirave të brendshme sipas nivelit të dyshemesë në ndërtesat e monitoruara

Tabela 9. Lidhja midis pranisë së llojeve të ndryshme të ngarkesës mikrobiale dhe shkallës së lagështisë në zonat e dukshme të mykut në klasë

Tabela 10. Lidhja midis pranisë së ngarkesës mikrobiale (veçanërisht kërpudhore dhe pigmente mikrobiale) dhe shkallës së lagështisë në zonat me myk në klasë

Tabela 11. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale (koloni kërpudhore dhe bakteriale) dhe shkallës së lagështisë së zonave të dukshme të mykut në klasë

Tabela 12. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe shkallës së lagështisë së zonave të dukshme të mykut në klasë

Tabela 13. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe dëmtimit në materialet e ndërtimit për shkak të ujit/lagështisë në klasë

Tabela 14. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe dëmtimit në materialet e ndërtimit për shkak të ujit/lagështisë në klasë

Tabela 15. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe dëmtimit në materialet e ndërtimit për shkak të ujit/lagështisë në klasa

Tabela 16. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojeve të ngarkesës mikrobiale dhe dëmtimit në materialet e ndërtimit për shkak të ujit/lagështisë në ambiente klase

Tabela 17. Lidhjet statistikore midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së një tualeti me ujë brenda ndërtesës së shkollës

Tabela 18. Lidhjet statistikisht domethënëse/jo domethënëse midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së një tualeti me ujë brenda ndërtesës së shkollës

Tabela 19. Lidhjet statistikisht domethënëse/jo domethënëse midis llojeve të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së një tualeti me ujë brenda ndërtesës së shkollës

Tabela 20. Lidhjet statistikisht domethënëse/jo domethënëse midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së një tualeti me ujë brenda ndërtesës së shkollës

Tabela 21. Lidhjet statistikisht domethënëse/jo domethënëse midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së insekteve në tualetet e shkollave

Tabela 22. Lidhjet statistikisht domethënëse/jo domethënëse midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së insekteve në tualetet e shkollave

Tabela 23. Lidhjet statistikisht domethënëse/jo domethënëse midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së insekteve në tualetet e shkollave

Tabela 24. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së insekteve në tualetet e shkollave

Tabela 25. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së rrjedhjeve nga tubat ose WC në tualetet e shkollës

Tabela 26. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së rrjedhjeve nga tubat ose WC në tualetet e shkollës

Tabela 27. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së rrjedhjeve nga tubat apo WC në tualetet e shkollës

Tabela 28. Lidhjet sinjifikative dhe jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së rrjedhjeve nga tubat apo WC në tualete

Tabela 29. Lidhjet midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe përshtatshmërisë së temperaturës në zonën e tualetit

Tabela 30. Lidhjet statistikore midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe përshtatshmërisë së temperaturës në zonën e tualetit

Tabela 31. Lidhjet statistikore midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe përshtatshmërisë së temperaturës në zonën e tualetit

Tabela 32. Lidhjet statistikore ndërmjet llojit të ngarkesës mikrobiale dhe përshtatshmërisë së temperaturës në zonën e tualetit

Tabela 33. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së ndonjë pjese të murit ku boja/suva bie

Tabela 34. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së pjesëve të dëmtuara në mur (rrënie e bojës/suvës) në zonën e tualetit

Tabela 35. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe ndonjë pjese të murit ku boja/suva bie

Tabela 36. Lidhjet statistikore midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së ndonjë pjese të murit ku boja apo suva bie

Tabela 37. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së lagështisë në tavan

Tabela 38. Lidhjet statistikore ndërmjet llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së lagështisë në tavan

Tabela 39. Lidhjet statistikisht sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së lagështisë në tavan.

Tabela 40. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së lagështisë në tavan

Tabela 41. Lidhjet statistikore midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së mykut në ndonjë pjesë të murit që është pastruar (n = 50)

Tabela 42. Lidhjet sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së mykut në ndonjë pjesë të murit që është pastruar

Tabela 43. Lidhjet statistikore midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së mykut në ndonjë pjesë të murit që është pastruar (n = 50)

Tabela 44. Lidhjet statistikisht sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe prezencës së mykut në ndonjë pjesë të murit që është pastruar (n = 50)

Tabela 45. Lidhjet sinjifikative/ jo sinjifikative midis llojit te ngarkeses mikrobiale dhe prezences se rrjedhjes se tubave te tualetit

Tabela 46. Lidhjet statistikisht sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së rrjedhjes së tubave të tualetit (n = 50)

Tabela 47. Lidhjet statistikisht sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së rrjedhjeve të tubave të tualetit (n = 50)

Tabela 48. Lidhjet sinjifikative/ jo sinjifikative midis llojit te ngarkeses mikrobiale dhe prezences se rrjedhjes se tubave te tualetit

Tabela 49. Rezultatet e testit MANOVA për ndikimin e variablave në ngarkesën mikrobiale

Tabela 50. Rezultatet e analizës së variablës Candida spp dhe ndikimit të saj

Tabela 51. Rezultatet e Testeve Multivariat për Ndikimin e Variablave në Model

Tabela 52. Rezultatet e analizës së variablave në lidhje me ngarkesën mikrobiale dhe ndikimin e tyre statistik

Tabela 53. Ngarkesa mikrobike në pesë shkolla fillore të qytetit të Korçës

Tabela 54. Rezultatet e ngarkesës mykotike në pesë shkolla fillore të qytetit të Korçës.

Tabela 55. Rezultatet nga pesë shkolla fillore në qytetin e Vlorës (numri mesatar i kolonive për pjatë Petri)

Tabela 57. Rezultatet nga grupi i dytë i shkollave në qytetin e Vlorës.

Tabela 58. Rezultatet nga katër shkolla fillore në qytetin e Malësisë së Madhe.

Tabela 59. Rezultatet e monitorimit të ngarkesës totale mikrobike dhe mykotike në katër shkolla të Kukësit.

Tabela 60. Rezultatet e monitorimit të ngarkesave totale mikrobike dhe mykotike në gjashtë shkolla të rrethit të Fierit.

Tabela 61. Përhapja e mikroorganizmave në zonat e ndryshme të shkollës Kosova

Tabela 62. Ngarkesa mikrobiale në terrenet PCA dhe Capek(SHKOLLA KOSOVA)

Tabela 63. Përmbledhje e përhapjes së mikroorganizmave në zonat e ndryshme të shkollës dhe çfarë sinjalizojnë ato.(Shkolla 7 Marsi)

Tabela 64. Ngarkesa mikrobiale dhe mykotike në pjatat e Petrit. Shkolla 7 Marsi
Tabela 65. Përhapja e mikroorganizmave në zonat e ndryshme të Shkollës së Baletit
Tabela 66. Ngarkesa mikrobiale në dy terrenet e përdorura për cilësinë e ajrit në shkollën e Baletit
Tabela 67. Për disa shkolla në Tiranë u mat ngarkesa mikrobike vetëm në oborre
Tabela 68. Përmbajtja mikrobike në oborret e shkollave në Tiranë
Tabela 69. Ngarkesa e baktereve dhe myqeve në oborr, korridore dhe klasa.(parashikim)
Tabela 70. Vlerësimi mikrobiologjik i ajrit në oborret e shkollave të Kavajës

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Paraqitje grafike e numrit të ngarkesave mikrobike të izoluara në shkollat e rrethit të Korçës (numri i mikroorganizmave për pjatë Petri).

Figura 2. Qarkullimi indoor/outdoor & ekspozimi i njerëzve ndaj tyre

Figura 3. Shpërndarja e ngarkesave indoor & formimi i biofilmave dhe bioaerosoleve në ajër

Figura 4. Pamje të përftuara nga studime në fushën e ndotjes mikrobiologjike te ajrit *(www.vecteezy.com)*

Figura 5. Ngarkesa mikrobiologjike në ajër nga studimet bashkëkohore. Majtas:: *arinspiredpencil.com*, Djathtas: *bioaerosole indoor* https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Common_Bioaerosol_Isolated_From_Indoor_Environments.JPG

Figura 6. Ngarkesa mikrobiologjike në ajër nga studimi ynë (shkolla NV-Korçë)

Figura 7. Ngarkesa mikrobiologjike në ajër nga studimi ynë (shkolla Th.G.-Korçë)

Figura 8. Prodigiozina, kolonitë e zhvilluara dhe tretësira e përqëndruar e prodigiozinës së pastër në etanol sipas *www.researchgate.net*

Figura 9. Ngarkesat totale ne CAPEK (mikroorganizma ne pjate Petri) në mostrat e marra në shkollat e Korçës, krahasuar me ngarkesat mykore në të njejtin terren.

Figura 10. Ngarkesat mykore në përqindje në mostrat e marra në shkollat e Korçës, krahasuar me ngarkesat totale në Capek.

Figura 11. Paraqitje grafike e numrit të ngarkesave mikrobike të izoluara nga shkollat në Vlorë (numri mesatar i mikroorganizmave për pjatë Petri).

Figura 12. Ngarkesat totale ne CAPEK (mikroorganizma në pjatë Petri) në mostrat e marra në shkollat e Vlorës (grupi i parë), krahasuar me ngarkesat mykore në të njejtin terren.

Figura 13. Ngarkesat mykore në perqindje ne mostrat e marra në shkollat e Vlorës (grupi pare), krahasuar me ngarkesat totale ne Capek.

Figura 14. Ngarkesat totale mikrobike në median CAPEK (mikroorganizma për pjatë Petri) në mostrat e mbledhura nga shkollat në Vlorë (grupi 1).

Figura 15. Përqindja e ngarkesës mykotike në mostrat e mbledhura nga shkollat në Vlorë (Grupi 1), krahasuar me ngarkesën totale në median CAPEK.

Figura 16. Ngarkesa totale mikrobike (numri i mikroorganizmave për pjatë Petri) në median PCA në grupin e dytë të shkollave në Vlorë.

Figura 17. Ngarkesa totale mykotike (numri i kërpudhave për pjatë Petri) në median CAPEK në grupin e dytë të shkollave në Vlorë.

Figura 18. Ngarkesa mykore në % të ngarkesave totale në terren CAPEK në grupin e dytë të shkollave të Vlorë

Figura 19. Ngarkesat mykore në CAPEK në shkollat e Vlorës - grupi i dytë.

Figura 20. Paraqitje grafike e ngarkesave totale mikrobike në shkollat e Malësisë së Madhe (media MPA).

Figura 21. Paraqitja e përqindjes së ngarkesës mykotike krahasuar me ngarkesën totale në median PDA në shkollat e Malësisë së Madhe.

Figura 22. Myqe në oborr të shkollës Prekë Gjoni-Bajzë (prani e *Trichoderma viride*)

Figura 23. Myqe në klasë, në shkollën Abdyl Bajraktari Koplik.

Figura 24. Myqe në oborr tek shkolla Muhamet Hasmuja – Grizh

Figura 25. Myqe në klasë tek shkolla Muhamet Hasmuja - Grizh.

Figura 26. Antibiotikët me unazën e β laktamit dhe emërtimet e tyre

Figura 27. Ngarkesat e mikroorganizmave në terren CAPEK në shkollat e Kukësit

Figura 28. Myqet e izoluara në proçes studimi morfologjik

Figura 29. Ngarkesa totale mikrobike (TVC) në median PCA në shkollat e Kukësit.

Figura 30. Ngarkesa totale dhe mykotike në median CAPEK (ngjyra e kuqe – ngarkesat totale, ngjyra blu – ngarkesat mykotike).

Figura 31. Myqet në perqindje të ngarkesave totale në CAPEK në shkollat e Kukësit

Figura 32. Ngarkesat totale mikrobike në median PCA në shkollat e Fierit.

Figura 33. Ngarkesat mykotike në median CAPEK në shkollat e Fierit.

Figura 34. Krahasimi i ngarkesës bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të Shkolles Kosova.

Figura 35: Pamje e garkeses mikrobiale ne terren PCA. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase *Shkolla Kosova*:

Figura 36: Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren Capek. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase *Shkolla Kosova*

Figura 37. Krahasimi i ngarkesës bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të Shkolles 7 Marsi.

Figura 38. Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren PCA. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase, Shkolla 7 Marsi

Figura 39. Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren Capek. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase, Shkolla 7 Marsi.

Figura 40. Krahasimi i ngarkesës bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të Shkollës së Baletit.

Figura 41. Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren PCA. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase, Shkolla e Baletit

Figura 42. Pamje e ngarkesës mikrobiale në terren Capek. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase, Shkolla e Baletit

Figura 43. Foto nga mikroflora e ajrit outdoor (oborre) në shkolla të ndryshme të Tiranës.

Figura 44. Sinjalizimi i riskut mikrobiologjik në ajrin outdoor të shkollave

Figura 45. Koloni bakteriale pigmentuese (të verdha, portokalli dhe të bardha

LISTA E FOTOVE

Foto 1. Shkolla "Ismail Qemali" – Vlorë (Vendet e mostrimit në oborr)

Foto 2. Shkolla "Ismail Qemali" – Vlorë (Vendet e mostrimit në korridor)

Foto 3. Shkolla "Halim Xhelo" – Vlorë (Vendi i mostrimit në oborr)

Foto 4. Shkolla "Jani Minga" – Vlorë (Vendet e mostrimit në oborr)

Foto 5. Shkolla "Pilo Prifti" - Novoselë – Vlorë (Vendet e mostrimit në oborr)

Foto 6. Gjinia *Mucor* dhe përhapja përmes sporangiosporave**.** *Viquipedia, encyclopedia iliure*

Foto 7. Specia *Mucor mucedo* marrë nga *James Lindsey at Ecology of Commanster*

Foto 8. Specia *Mucor mucedo* me riprodhim aseksual, e rritur ne domate, marrë nga *Sciencefotolibrary*

Foto 9. *Blastomyces dermatitidis* marre nga *depositphotos*

Foto 10. Pamje në mikroskop të konidieve të *Trichoderma viride (Gerald Holmes,* Strawberry Center, Cal Poly San Luis Obispo, Bugwood.org)

Foto 11. Cladosporium spp.- zhvillimi në Pjatë Petri

Foto 12. Pamja në mikroskop optik sipas *ALAMY dhe Alchetron.com*

Foto 13. Zhvillimi i kolonive të *Aureobazidium pullulans* marrë nga *NARO Genebank***.**

Foto 14. Makro dhe mikromorfologjia e *Aureobasidium pullulans* marrë nga *Researchgate*

Foto 15. Shkolla e Bajzës në Malësi të madhe. Vëndi ku u bë mostrimi në oborr.

Foto 16, Shkolla "Abdyl Bajraktari" – Koplik, mostrimi Maj 2025 (a)

Foto 17. Shkolla Muhamet Hasmuja-Grizhë Vëndet ku u bë mostrimi në oborr.

HYRJE

Cilësia e ajrit të brendshëm është një faktor thelbësor në ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së individëve, sidomos në mjedise ku qëndrimi është i zgjatur dhe densiteti njerëzor është i lartë, siç janë shkollat. Shumë studime kanë treguar se ndotja e ajrit të brendshëm ndikon negativisht jo vetëm në shëndetin fizik, por edhe në performancën njohëse dhe aftësitë përqendruese të nxënësve (Mendell & Heath, 2005). Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë i kushtohet ndotjes mikrobiologjike, e cila shpeshherë mbetet e anashkaluar në vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së ajrit.

Cilësia e ajrit të brendshëm është një aspekt themelor i shëndetit publik, sidomos në mjedise të mbyllura ku njerëzit kalojnë shumicën e kohës së tyre. Në institucione arsimore si shkollat, ndotja e ajrit të brendshëm përbën një shqetësim të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së lartë të fëmijëve ndaj ndotësve fizikë, kimikë dhe biologjikë (Mendell & Heath, 2005). Fëmijët marrin frymë më shpejt se të rriturit dhe kanë një sistem respirator në zhvillim, ndaj janë më të ekspozuar ndaj efekteve të dëmshme të ndotësve që qarkullojnë në ajër.

Burimet e ndotjes së ajrit të brendshëm janë të shumta dhe përfshijnë emetimet nga materialet ndërtimore, mobiliet, produktet e pastrimit dhe aparaturat elektrike. Ndër ndotësit më të zakonshëm përfshihen komponimet organike të paqëndrueshme (VOC), pluhurat e imët (PM2.5 dhe PM10), formaldehidi, si dhe dioksidi i karbonit (CO_2), i cili në klasa të mbipopulluara rritet ndjeshëm dhe ndikon negativisht në përqendrimin e nxënësve (Bakó-Biró et al., 2012). Studime të shumta kanë treguar se ekspozimi i gjatë ndaj këtyre ndotësve lidhet me probleme të sistemit respirator, alergji dhe ulje të performancës kognitive (Daisey, Angell, & Apte, 2003; WHO, 2010).

Një dimension shtesë i rëndësishëm i ndotjes së ajrit të brendshëm është ndotja mikrobike**,** e cila përfshin praninë e mikroorganizmave si bakteret, viruset dhe myqet. Këto mikroorganizma mund të përhapen përmes sistemit të ventilimit, nga njerëzit ose për shkak të kushteve të lagështa që nxisin rritjen e mykut (Shaughnessy & Haverinen-Shaughnessy, 2015). Sporet e mykut si *Aspergillus* dhe *Penicillium* janë të zakonshme në ambientet me lagështi të lartë dhe mund të shkaktojnë reaksione alergjike, astmë, si dhe infeksione respiratore, veçanërisht te personat me sistem të dobët imunitar (WHO, 2010).

Problemet me cilësinë e ajrit shpesh përkeqësohen nga mungesa e mirëmbajtjes së sistemeve të ventilimit dhe pastrimit, si dhe nga mungesa e monitorimit të rregullt. Rekomandohet që shkollat dhe institucionet arsimore të marrin masa parandaluese, duke përfshirë ventilim natyral ose

mekanik adekuat, përdorimin e materialeve të ndërtimit me emetime të ulëta dhe pastrimin periodik të sipërfaqeve dhe filtrave të ajrit (Mendell & Heath, 2005; Shaughnessy & Haverinen-Shaughnessy, 2015).

Në përfundim, ndotja e ajrit të brendshëm, përfshirë atë mikrobike, përbën një rrezik real për shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe stafit në shkolla. Përmirësimi i infrastrukturës, edukimi i komunitetit shkollor dhe aplikimi i standardeve të qarta të ventilimit janë hapa të domosdoshëm për të garantuar një mjedis të shëndetshëm mësimor.

Ndotja e ajrit të brendshëm: përbërja dhe burimet kryesore

Ajri i brendshëm mund të përmbajë një sërë ndotësish kimikë, fizikë dhe biologjikë, të cilët vijnë nga burime të ndryshme si materialet ndërtimore, produktet e pastrimit, pajisjet elektrike, si dhe vetë prania dhe aktiviteti i njerëzve. Ndër ndotësit më të zakonshëm përmenden komponimet organike të paqëndrueshme (VOC), formaldehidi, pluhurat e imët (PM2.5 dhe PM10), dioksidi i karbonit (CO_2) dhe ndotës të tjerë që ndikojnë në cilësinë e frymëmarrjes dhe në shëndetin respirator (WHO, 2010). Në mjediset shkollore, ku klasat shpesh janë të mbipopulluara dhe dritaret mbahen të mbyllura për shkak të kushteve klimatike, ndotësit grumbullohen lehtësisht. Daisey, Angell dhe Apte (2003) theksojnë se mungesa e ventilimit adekuat është një nga faktorët kryesorë që çon në përqendrime të larta të ndotësve të brendshëm, duke kontribuar në përkeqësimin e simptomave respiratore dhe sëmundjeve alergjike.

Ndotja mikrobiologjike e ajrit

Ndryshe nga ndotësit fizikë dhe kimikë, ndotja mikrobiologjike i referohet pranisë së mikroorganizmave në ajër, përfshirë bakteret, virusët, sporet e mykut dhe kërpudhave të tjera. Këta ndotës të padukshëm janë shpesh të pezulluar në ajër dhe mund të merren lehtësisht përmes frymëmarrjes, duke përbërë një rrezik serioz për shëndetin, sidomos për fëmijët dhe personat me imunitet të dobësuar. Burimet e ndotjes mikrobike përfshijnë lagështinë e mjedisit, sipërfaqet e kontaminuara, mungesën e higjienës dhe vetë njerëzit, të cilët përhapin mikroorganizma përmes frymëmarrjes, kollitjes dhe teshtimës (Shaughnessy & Haverinen-Shaughnessy, 2015).

Lagështia është një ndër faktorët më të rëndësishëm që nxit rritjen e mykut dhe kërpudhave në ambientet e mbyllura. Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO, 2010) thekson se ekspozimi i vazhdueshëm ndaj mykut lidhet me rritjen e rrezikut për zhvillimin e astmës dhe alergjive respiratore, veçanërisht tek fëmijët. Lloje të zakonshme të mykut të pranishëm në ajrin e

brendshëm përfshijnë *Aspergillus*, *Cladosporium* dhe *Penicillium*, të cilat janë identifikuar si burime të sëmundjeve të rënda respiratore në studime ndërkombëtare.

Ndikimi i ndotjes së ajrit në shkolla

Në kontekstin e shkollave, ndotja e ajrit të brendshëm, përfshirë komponentin mikrobik, lidhet drejtpërdrejt me uljen e përqendrimit të nxënësve, lodhjen, rritjen e mungesave për arsye shëndetësore dhe përkeqësimin e performancës akademike. Një studim nga Bakó-Biró et al. (2012) tregoi se nivelet e larta të CO_2 në klasat e shkollave ishin të lidhura me rënie të ndjeshme në performancën e detyrave kognitive tek nxënësit. Këto efekte përkeqësohen kur ajri është i ngarkuar edhe me mikroorganizma patogjenë, të cilët ndikojnë në rritjen e infektimeve dhe simptomave të frymëmarrjes.

Mendell dhe Heath (2005) argumentojnë se mjediset shkollore me ventilim të pamjaftueshëm përjetojnë jo vetëm përkeqësim të simptomave të sëmundjeve ekzistuese si astma, por edhe një prevalencë më të lartë të sëmundjeve të reja të traktit respirator. Prandaj, vlerësimi i ndotjes së ajrit në shkolla nuk duhet të fokusohet vetëm te ndotësit klasikë, por edhe te përbërësit biologjikë, të cilët mund të kenë pasoja të konsiderueshme në shëndetin afatgjatë të nxënësve.

Studimet ekzistuese dhe boshllëqet në literaturë

Ndërsa në vendet perëndimore janë realizuar një numër i konsiderueshëm studimesh mbi ndotjen e ajrit të brendshëm në shkolla, përfshirë matjet e mikroorganizmave në ajër, në Shqipëri mungojnë të dhëna sistematike dhe studime të thelluara mbi këtë temë. Shumica e vlerësimeve ekzistuese janë të fokusuara në ndotjen e jashtme ose ndotjen e ujit dhe ushqimit, ndërsa cilësia e ajrit të brendshëm në shkolla është shpesh e neglizhuar si objekt studimi.

Ky boshllëk në literaturë krijon nevojën për kërkime të fokusuara në kontekstin shqiptar, për të kuptuar më mirë nivelet reale të ndotjes mikrobiologjike në ambientet mësimore dhe për të përcaktuar masat parandaluese që mund të merren nga institucionet përkatëse. Kërkimi aktual synon të japë një kontribut në këtë drejtim, duke sjellë të dhëna të reja dhe duke promovuar vetëdijen mbi rëndësinë e higjienës së ajrit në shkolla

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të realizojë një vlerësim të detajuar dhe sistematik të ekspozimit ndaj ndotjes së ajrit të brendshëm në shkollat 9-vjeçare në Shqipëri, me fokus të veçantë

në ndotjen mikrobiologjike të ajrit. Studimi synon të identifikojë dhe karakterizojë përbërësit mikrobiologjikë të ajrit në ambientet mësimore, si dhe të analizojë faktorët mjedisorë dhe infrastrukturore që ndikojnë në nivelin e ekspozimit të nxënësve dhe stafit shkollor ndaj këtyre ndotësve.

Nëpërmjet një qasjeje multidimensionale që përfshin matje laboratorike, inspektime në terren dhe mbledhjen e të dhënave përmes instrumenteve strukturuara, ky studim ka për qëllim të kontribuojë në zgjerimin e bazës së njohurive mbi cilësinë e ajrit të brendshëm në institucionet arsimore në Shqipëri. Për më tepër, rezultatet pritet të shërbejnë si bazë për rekomandime praktike dhe politike për përmirësimin e kushteve mjedisore në shkolla, duke ndikuar pozitivisht në shëndetin dhe mirëqenien e komunitetit shkollor

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky studim ka për qëllim të vlerësojë ekspozimin ndaj ndotjes së ajrit të brendshëm, me fokus të veçantë në ndotjen mikrobiologjike në shkollat 9-vjeçare në Shqipëri. Për realizimin e këtij vlerësimi, është aplikuar një qasje e kombinuar kërkimore, që përfshin mbledhjen e të dhënave si përmes instrumenteve të strukturuara (pyetësorë dhe formularë inspektimi), ashtu edhe përmes analizës laboratorike të kampioneve të ajrit në ambiente të brendshme shkollore.

Përzgjedhja e kampionit të studimit

Në total janë përfshirë 50 shkolla 9-vjeçare**,** të përzgjedhura në mënyrë të shpërndarë gjeografikisht në gjashtë rrethe të Shqipërisë, me qëllim për të pasur një përfaqësim sa më të gjerë të kushteve të ndryshme mjedisore dhe infrastrukturore. Shpërndarja e shkollave është si më poshtë:

- Tiranë**:** 20 shkolla
- Vlorë**:** 10 shkolla
- Fier**:** 7 shkolla
- Korçë**:** 5 shkolla
- Kukës**:** 4 shkolla
- Malësi e Madhe**:** 4 shkolla

Përzgjedhja e shkollave është bërë duke pasur parasysh diversitetin në tipologji ndërtimore, zonat urbane dhe rurale, si dhe karakteristikat klimatike rajonale.

Instrumentet e përdorura në studim

Për të mbledhur informacionin në mënyrë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, janë zhvilluar dhe aplikuar pesë pyetësorë dhe formularë inspektimi**,** të cilët mbulojnë aspekte të ndryshme të mjedisit të brendshëm të shkollave:

- *Pyetësori i administratorit të shkollës*

  Ky pyetësor ka mbledhur informacion mbi karakteristikat e përgjithshme të ndërtesës, kohëzgjatjen e funksionimit të saj, numrin e nxënësve dhe stafit, mirëmbajtjen, si dhe praktikat aktuale të ajrosjes dhe pastrimit;
- *Inspektimi i shkollës*

  Ky formular ka vlerësuar kushtet fizike të ndërtesës, përfshirë strukturën, muret, dyshemetë, tavanet dhe sistemin e ventilimit, me qëllim identifikimin e faktorëve që mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit të brendshëm.
- *Inspektimi për praninë e mykut*

  Përmes këtij formulari, janë identifikuar shenja vizuale të pranisë së mykut ose lagështisë së tepërt, si njolla të errëta në mure, aroma karakteristike ose dëmtime të materialeve ndërtimore.
- *Kontrolli i klasës*

  Është vlerësuar çdo klasë për karakteristikat e ambientit: dendësia e nxënësve, numri i dritareve, niveli i ajrosjes natyrore dhe i ndriçimit, temperatura, si dhe pastërtia e sipërfaqeve.
- *Inspektimi i tualeteve*

  Janë kontrolluar tualetet për pastërti, sistemin e ventilimit, aromat e pranishme dhe mirëmbajtjen e përgjithshme, pasi këto ambiente përbëjnë burime të mundshme të ndotjes mikrobike.

Marrja e kampioneve të ajrit dhe analiza mikrobiologjike

Për çdo shkollë janë marrë kampione të ajrit të brendshëm**,** të mbledhura në ambiente përfaqësuese si klasat mësimore dhe korridoret, në disa raste edhe në tualete. Kampionet janë marrë në mënyrë standarde, në përputhje me praktikat e njohura për mbledhjen e bioaerozolëve.

Këto kampione janë analizuar për përmbajtjen mikrobiologjike**,** përfshirë:

- Numrin total të baktereve aerobe mezofile

- Numrin total të kërpudhave dhe myqeve
- Identifikimin e kolonive të zakonshme si *Aspergillus*, *Penicillium*, *Cladosporium*, etj.

Analizat janë realizuar në kushte laboratorike të kontrolluara, duke përdorur metoda të kulturës në pllakë (plate count method), me inkubim në temperatura të përcaktuara për 48–72 orë. Rezultatet janë interpretuar në raport me udhëzimet ndërkombëtare për nivelin e pranueshëm të mikroorganizmave në ajrin e brendshëm (WHO, 2009; EU Guidelines).

Trajtimi dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët dhe inspektimet janë analizuar në mënyrë deskriptive, duke krahasuar faktorët që ndikojnë në ndotjen e ajrit me rezultatet e analizave laboratorike. Krahasimet janë bërë midis shkollave të ndryshme, sipas rajonit, tipologjisë së ndërtesës dhe praktikave të mirëmbajtjes, me qëllim identifikimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet kushteve mjedisore dhe niveleve të ndotjes mikrobike

REZULTATET

Sa i përket të dhënave të paraqitura në tabelën 1, rezulton se shumica dërrmuese e shkollave të përfshira në vlerësim janë institucione publike (98%), ndërsa nuk është raportuar asnjë shkollë private. Vetëm në një rast (2%) mungon informacioni mbi formën e menaxhimit. Sa i takon llojit të shkollës, 94% e tyre janë shkolla të arsimit të përgjithshëm, ndërsa vetëm një shkollë është e tipit konvikt dhe një tjetër është shkollë speciale; në një rast mungon informacioni. Në lidhje me përbërjen fizike të shkollave, 98% e tyre kanë vetëm një godinë me klasa, ndërsa nuk është raportuar asnjë shkollë me dy ose më shumë godina; edhe në këtë rast, një shkollë (2%) nuk ka dhënë informacion. Kjo pasqyrë e përgjithshme sugjeron një sistem shkollor të standardizuar në aspektin e infrastrukturës dhe menaxhimit, me dominuese shkollat publike dhe struktura të thjeshta një-godinë.

Tabela 1. Karakteristikat strukturore dhe menaxheriale të shkollave të përfshira në vlerësim

Menaxhimi i shkolles	**Frekuenca**	**Perqindja**
Publike	49	98.0
Private	0	0.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0
Lloji i shkolles	**Frekuenca**	**Perqindja**
Shkolle e arsimit te pergjithshem	47	94.0
Shkolle me konvikt	1	2.0

Shkolle speciale	1	2.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0
Nga sa godina me klasa perbehet shkolla?	**Frekuenca**	**Perqindja**
1 godine	49	98.0
2 godina	0	0.0
3 ose me shume godina	0	0.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0

Të dhënat tregojnë se grupmoshat më të përfaqësuara në shkolla janë fëmijët nga 6 deri në 14 vjeç, ku 86% e shkollave raportojnë praninë e nxënësve në grupmoshat 6-8, 9-11 dhe 12-14 vjeç. Në anën tjetër, grupmoshat më të vogla se 6 vjeç dhe më të rritura, nga 15 deri në 18 vjeç, janë më pak të përfshira në shkolla, me vetëm 22% të shkollave që raportojnë praninë e këtyre moshave.
Sa i përket nxënësve me aftësi të kufizuara fizike, në shumicën e shkollave numri i nxënësve djem me këtë karakteristikë varion, ku 46% e shkollave nuk kanë asnjë nxënës me aftësi të kufizuara, ndërsa shkollat e tjera raportojnë nga 1 deri në 10 nxënës me këtë aftësi. Përsa i përket vajzave me aftësi të kufizuara fizike, 58% e shkollave nuk kanë asnjë nxënëse me këtë karakteristikë, ndërsa pjesa tjetër raporton prezencën e disa nxënëseve, nga 1 deri në 13 në raste të veçanta. Mungesa e informacionit për këtë aspekt është minimale (rreth 4%). Këto të dhëna reflektojnë një përfshirje të ndryshueshme të nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla, duke treguar nevojën për vëmendje të shtuar ndaj integrimit dhe mbështetjes së tyre *(shiko tabelën 2)*.

Tabela 2. Përbërja e grupmoshave të nxënësve dhe prezenca e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike në shkolla

Grupmoshat e nxenesve ne shkolle	**Frekuenca/Perqindja**		
	Po	Jo	Mungon
Me pak se 6 vjec	11 (22.0)	38 (76.0)	1 (2.0)
6-8 vjec	43 (86.0)	6 (12.0)	1 (2.0)
9-11 vjec	43 (86.0)	6 (12.0)	1 (2.0)
12-14 vjec	43 (86.0)	6 (12.0)	1 (2.0)
15-18 vjec	11 (22.0)	38 (76.0)	1 (2.0)
Numri i nxenesve (djem) me aftesi te kufizuara fizike	**Frekuenca**	**Perqindja**	
0 nxenes	23	46.0	
1 nxenes	8	16.0	
2 nxenes	6	12.0	
3 nxenes	3	6.0	
4 nxenes	1	2.0	
5 nxenes	1	2.0	
7 nxenes	2	4.0	
8 nxenes	1	2.0	
9 nxenes	2	4.0	

10 nxenes	1	2.0
Mungon	2	4.0
Total	50	100.0
Numri i nxenesve (vajza) me aftesi te kufizuara fizike	**Frekuenca**	**Perqindja**
0 nxenes	29	58.0
1 nxenese	10	20.0
2 nxenese	2	4.0
3 nxenese	4	8.0
4 nxenese	1	2.0
5 nxenese	1	2.0
13 nxenese	1	2.0
Mungon	2	4.0
Total	50	100.0

Rezultatet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e ndërtesave shkollore është mjaft e vjetër, ku 38% e tyre janë mbi 50 vjeç, ndërsa 24% janë ndërtuar para 11-30 vjetësh. Sa i përket strukturës së ndërtesës, shumica kanë 2 ose 3 kate (36% dhe 40% përkatësisht), ndërsa vetëm 20% janë me 4 kate. Numri i klasave në shkolla varion ndjeshëm, me shumicën që kanë nga 9 deri në 40 klasa, duke reflektuar dallime në madhësinë dhe kapacitetin e shkollave. Përsa i përket kushteve sanitare, 76% e shkollave kanë tualete të lidhura me tubacion, ndërsa vetëm një pjesë e vogël përdorin tualete të thata apo me derdhje të vrullshme. Ky përmbledhje tregon sfidat e infrastrukturës së shkollave, veçanërisht lidhur me moshën e ndërtesave dhe kapacitetin, por edhe përmirësimet në kushtet sanitare në shumicën e shkollave.

Tabela 3. Karakteristikat infrastrukturore të ndërtesave shkollore

Sa e vjeter eshte ndertesa e shkolles?	**Frekuenca**	**Perqindja**
1 deri ne 10 vjec	7	14.0
11 deri ne 30 vjec	12	24.0
31 deri ne 50 vjec	11	22.0
Ndertesa eshte me shume se 50 vjet e vjeter	19	38.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0
Sa eshte numri i pergjithshem i kateve ne ndertese	**Frekuenca**	**Perqindja**
2 kateshe	18	36.0
3 kateshe	20	40.0
4 kateshe	10	20.0
Mungon	2	4.0
Total	50	100.0
Sa eshte numri i pergjithshem i klasave?	**Frekuenca**	**Perqindja**
5 klasa	1	2.0
8 klasa	1	2.0
9 klasa	5	10.0
13 klasa	3	6.0

14 klasa	1	2.0
15 klasa	1	2.0
18 klasa	4	8.0
20 klasa	2	4.0
21 klasa	1	2.0
22 klasa	2	4.0
23 klasa	2	4.0
24 klasa	1	2.0
25 klasa	3	6.0
26 klasa	1	2.0
27 klasa	3	6.0
28 klasa	3	6.0
32 klasa	3	6.0
34 klasa	1	2.0
35 klasa	1	2.0
36 klasa	3	6.0
38 klasa	1	2.0
40 klasa	1	2.0
Mungon	6	12.0
Total	50	100.0

Cfare lloj tualeti ka shkolla?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Tualet i thate	6	12.0
Tualet me derdhje te vrullshme	4	8.0
Tualet i lidhur me tubacion	38	76.0
Mungon	2	4.0
Total	50	100.0

Rezultatet tregojnë një shpërndarje të ndryshme të sipërfaqeve të objekteve shkollore, ku shumica e shkollave kanë sipërfaqe që variojnë kryesisht nga rreth 1000 deri në 3500 metra katrorë. Ekzistojnë edhe disa shkolla me sipërfaqe më të vogla, nën 500 m², si dhe disa të tjera me sipërfaqe më të mëdha mbi 3000 m². Vetëm në pak raste mungon informacioni për sipërfaqen e objekteve. Kjo tregon një diversitet të konsiderueshëm në dimensionet fizike të shkollave të përfshira në studim.

Tabela 4. Sipërfaqja totale e objekteve shkollore sipas planimetrisë së ndërtesës

Siperfaqja totale e objektit sipas planimetrise se nderteses	**Frekuenca**	**Perqindja**
1000 m^2	3	6.0
1100 m^2	2	4.0
1200 m^2	1	2.0
1500 m^2	3	6.0
1700 m^2	1	2.0
1800 m^2	1	2.0
1804 m^2	1	2.0
183 m^2	1	2.0
2000 m^2	1	2.0

2100 m^2	3	6.0
2325 m^2	1	2.0
2350 m^2	1	2.0
2400 m^2	2	4.0
2500 m^2	1	2.0
2800 m^2	1	2.0
2850 m^2	1	2.0
2850 m^2	1	2.0
3000 m^2	3	6.0
3200 m^2	1	2.0
327.6 m^2	1	2.0
3300 m^2	2	4.0
3450 m^2	1	2.0
3500 m^2	2	4.0
3700 m^2	1	2.0
3800 m^2	1	2.0
390 m^2	1	2.0
450 m^2	2	4.0
645 m^2	2	4.0
800 m^2	2	4.0
850 m^2	1	2.0
868 m^2	1	2.0
890.3 m^2	1	2.0
922 m^2	1	2.0
Mungon	2	4.0
Total	50	100.0

Në lidhje me kushtet infrastrukturore, rreth 30% e shkollave raportuan përmbytje ose rrjedhje uji gjatë 12 muajve të fundit, një problem që mund të ndikojë negativisht në ambientin e brendshëm dhe shëndetin e nxënësve. Sa i përket mirëmbajtjes, 44% e shkollave kanë kryer riparime apo rinovime të mëdha gjatë pesë viteve të fundit, me një lidhje statistikisht të rëndësishme midis riparimeve dhe pranisë së rrjedhjeve të ujit ($p=0.023$). Kjo tregon se shkollat që kanë pasur rrjedhje uji kanë kryer riparime më së shumti, një shenjë që mirëmbajtja është e lidhur ngushtë me zgjidhjen e problemeve të tilla.

Në aspektin e ngrohjes, shumica e shkollave përdorin soba ose ngrohje të brendshme në dhoma individuale, ndërsa një pjesë më e vogël ka sistem ngrohjeje qendrore ose nuk ka sistem ngrohjeje fare. Prania e mykut brenda ambienteve është më e lartë në shkollat me soba të brendshme, duke treguar një lidhje të fortë mes metodës së ngrohjes dhe zhvillimit të mykut. Kjo lidhje është konfirmuar edhe statistikisht me një p-value prej 0.032, që tregon se ndryshimet në sistemet e ngrohjes janë të lidhura në mënyrë të rëndësishme me praninë e mykut në shkolla.

Në përgjithësi, këto rezultate sugjerojnë se mirëmbajtja e ndërtesave dhe lloji i sistemit të ngrohjes janë faktorë kyç që ndikojnë në cilësinë e ambientit të brendshëm dhe potencialisht në shëndetin e

nxënësve. Vlerat p të marra ($p<0.05$) tregojnë se këto lidhje janë statistikisht të rëndësishme dhe nuk janë rastësi, duke nënvizuar nevojën për fokus të shtuar në mirëmbajtjen e ndërtesave dhe përmirësimin e sistemit të ngrohjes në shkolla.

Tabela 5. Gjendja e infrastrukturës së shkollave dhe ndikimi i saj në kushte mjedisore

		A ka pasur ndonje rrjedhje uji apo permbytje ne 12 muajt e fundit?		**Total**	**P-value**
		Po	Jo		
A i eshte nenshtruar objektit te shkolles riparime, apo rinovime te medha gjate 5 viteve te fundit?	Jo	11	11	22	.023/7.547
	Po, brenda vitit te kaluar	1	8	9	
	Po, nga 1 deri ne 5 vjet me pare	3	16	19	
	Total	15	35	50	

		A ka zona te rritjes se mykut brenda nderteses?			**Total**	**P-value**
		Po	Jo	Nuk e di		
Sistemet e ngrohjes?	Nuk ka sistem ngrohje	1	1	0	2	.032/16.805
	Sistemi i ngrohjes qendrore	1	3	1	5	
	Sistemi i ngrohjes se shkolles per gjithe ndertesen	3	15	0	18	
	Soba ose ngrohes te brendshme ne dhoma individuale	10	13	0	23	
	Mungon	2	0	0	2	
	Total	17	32	1	50	

Nga të dhënat rezulton se 26% e shkollave kanë pasur rrjedhje nga tubat ose WC-ja e tualetit, ndërsa 74% nuk raportuan këtë problem. Përsa i përket temperaturës në zonën e tualeteve, 58% e tyre e vlerësuan si të përshtatshme, ndërsa 40% raportuan temperatura jo të përshtatshme. Të gjitha shkollat (100%) kanë ndarje të WC-ve që ruajnë privatësinë, dhe 90% e tualeteve kanë dyer që mund të mbyllen nga brenda, duke garantuar siguri dhe rehati. Në lidhje me pastrueshmërinë, 98% e tualeteve pastrohen lehtësisht.

Në aspektin e tualeteve të jashtme, mungon informacioni në shumicën e rasteve (76%) lidhur me aksesin dhe ndriçimin, por nga ato që u përgjigjën, vetëm 10% kanë rrugë të përdorshme në çdo mot dhe stinë, ndërsa vetëm 6% kanë ndriçim funksional në rrugën drejt tualetit.

Në përgjithësi, shumica e shkollave kanë kushte të mira private dhe higjienike në tualete, por ekziston nevoja për përmirësim të aksesit dhe ndriçimit në tualetet e jashtme.

Tabela 6. Gjendja dhe kushtet e tualeteve në shkolla

A ka ndonje rrjedhje nga tubat apo WC e tualetit?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	13	26.0
Jo	37	74.0
Total	50	100.0
A eshte temperature e pershtatshme ne zonen e tualetit?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	29	58.0
Jo	20	40.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0
A ka ndarje ndermjet WC qe ruajne privatesine?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	50	100.0
Jo	0	0.0
Total	50	100.0
Nese ka dyer, a mund te mbyllen nga brenda?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	45	90.0
Jo	4	8.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0
A pastrohen lehtesisht te gjitha tualetet?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	**49**	**98.0**
Jo	0	0.0
Mungon	1	2.0
Total	50	100.0
Per tualetet e jashtme, a ka nje rruge per ne tualet qe mund te perdoret lehtesisht ne cdo mot dhe stine?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	5	10.0
Jo	7	14.0
Mungon	38	76.0
Total	50	100.0
Per tualetet e jashtme, a ka drita qe funksionojne sic duhet ne rrugen per ne tualet?	**Frekuenca**	**Perqindja**
Po	3	6.0
Jo	9	18.0
Mungon	38	76.0
Total	50	100.0

Tabela 7 tregon shpërndarjen e 50 ndërtesave të studiuara sipas vendndodhjes së tyre dhe praninë e burimeve të mundshme të ndotjes së ajrit në afërsi të tyre. Më shumë se gjysma e ndërtesave (58.8%) ndodhen në zona urbane, ndërsa 25.5% ndodhen në zona rurale. Zona banimi e dendur në qytet dhe zona periferike përbëjnë përkatësisht 9.8% dhe 3.9% të totalit.

Sa i përket burimeve të ndotjes së ajrit pranë ndërtesave, parkimi i makinave brenda 100 metrave është burimi më i përhapur, duke u raportuar në 32% të rasteve. Megjithatë, më shumë se gjysma

e ndërtesave (56%) nuk kanë parkim makinash pranë. Garazhet e bashkengjitura janë të pakta, vetëm në 6% të rasteve, ndërsa 82% e ndërtesave nuk kanë këtë burim pranë.

Rrugët ose hekurudhat e ngarkuara qëndrojnë pranë 24% të ndërtesave, duke përfaqësuar një burim të rëndësishëm potencial të ndotjes. Termocentralet dhe pompat e benzinës nuk janë të pranishme në afërsi të asnjë prej ndërtesave të studiuara, gjë që sugjeron mungesën e këtyre burimeve specifike në zonat e monitoruara. Industria dhe termocentralet kryesore janë gjithashtu të munguar në një rreze prej 3 kilometrash nga të gjitha ndërtesat e studiuara.

Në kategorinë "tjetër", e cila përfshin burime të ndryshme potenciale të ndotjes, 32% e ndërtesave kanë burime të tilla në afërsi, ndërsa 56% nuk kanë dhe 12% mungojnë të dhënat.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se ndërtesat më së shumti përballen me ndotje nga trafiku dhe parkimi i makinave, ndërsa burimet industriale ose energjetike janë pak të pranishme në zonat e studiuara.

Tabela 7. Shpërndarja e vendndodhjes së ndërtesave dhe burimet e mundshme afër ndotjes së ajrit në zonat e studiuara

Vendndodhja e nderteses	**Frekuenca**	**Perqindja**	
Zone urbane	30	58.8	
Zone banimi e dendur ne qytet	5	9.8	
Zone periferike	2	3.9	
Zone rurale	13	25.5	
Total	50	98.0	
Burime te mundshme te aferta te ndotjes se ajrit e natyre	**Frekuenca/Perqindja**		
	Po	Jo	Mungon
Parkim makinash brenda 100m	16 (32.0)	28 (56.0)	6 (12.0)
Garazh i bashkengjitur	3 (6.0)	41 (82.0)	6 (12.0)
Rruge ose hekurudhe e ngarkuar (te pakten nje pjese e dites) brenda 100m	12 (24.0)	32 (64.0)	6 (12.0)
Termocentrali per ndertesen	0 (0.0)	44 (88.0)	6 (12.0)
Pompe benzine ose pajisje te tjera shperndarese benzine brenda 100m	0 (0.0)	44 (88.0)	6 (12.0)
Industria ose termocentralet kryesore brenda 3 km	0 (0.0)	44 (88.0)	6 (12.0)
Tjeter	16 (32.0)	28 (56.0)	6 (12.0)

Tabela 8 paraqet shpërndarjen e hapësirave të brendshme të ndërtesave të monitoruara sipas llojit të dhomës apo funksionit të saj dhe nivelit të dyshemesë ku ndodhet. Të dhënat përfshijnë gjithsej 50 ambiente të vëzhguara në ndërtesa arsimore dhe ofrojnë një pasqyrë të vendosjes së klasave dhe hapësirave të tjera në ndërtesa shumëkatëshe.

Dominues absolut në këtë shpërndarje janë klasat e rregullta, të cilat përbëjnë shumicën dërrmuese të hapësirave të evidentuara, me 41 nga 50 raste gjithsej. Këto klasa janë të shpërndara në të gjitha katet, por ndodhen kryesisht në katin e dytë, ku janë identifikuar 32 prej tyre. Një numër shumë më i vogël klasash ndodhen në katin përdhes dhe katin e parë, përkatësisht nga tre në secilin nivel. Për tre raste të tjera që përfshijnë klasa, të dhënat mbi nivelin e dyshemesë mungojnë.

Përveç klasave të rregullta, janë regjistruar edhe disa hapësira të tjera me funksione të veçanta, ndonëse në numër të kufizuar. Vetëm dy hapësira janë klasifikuar si ambiente të posaçme për mësimdhënie, të tilla si laboratorë apo dhoma për mësime specifike, të cilat janë vendosur njëra në katin përdhes dhe tjetra në katin e dytë. Po ashtu, është identifikuar vetëm një dhomë e përdorur zakonisht nga stafi i shkollës, si p.sh. zyrë apo dhomë personeli, e cila ndodhet në katin e dytë. Dy hapësira të tjera janë kategorizuar si ambiente që zakonisht nuk janë të zëna, si depo ose hapësira të pazhvilluara funksionalisht, dhe ndodhen gjithashtu në katin e dytë dhe në rastet kur mungojnë të dhënat.

Në total, për tetë nga hapësirat e monitoruara mungojnë të dhënat mbi nivelin e dyshemesë, çka përbën rreth 16% të rasteve dhe sugjeron nevojën për përmirësim në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.

Kjo shpërndarje reflekton se pjesa më e madhe e vlerësimeve janë përqendruar në ambientet ku nxënësit qëndrojnë më gjatë, veçanërisht në klasat e vendosura në katin e dytë. Një përqendrim i tillë ka rëndësi të veçantë për vlerësimin e ekspozimit të fëmijëve ndaj ndotjes së brendshme të ajrit apo faktorëve të tjerë ambientalë, duke qenë se këto ambiente janë më të përdorurat në procesin mësimor.

Tabela 8. Shpërndarja e llojit të hapësirave të brendshme sipas nivelit të dyshemesë në ndërtesat e monitoruara

		Niveli i dyshemese				
		Kati perdhes	Kati i pare	Kati i dyte	Mungon	Total
Lloji i dhomes/hapesires	Klasa e rregult	3	3	32	3	41
	Klase ose hapesire e vecante per mesimdhenie	1	0	1	0	2
	Dhomat e zena zakonisht vetem nga punonjesit e shkolles	0	0	1	0	1

Dhomat/hapesirat qe zakonisht nuk jane te zena	0	0	1	1	2
Mungon	0	0	0	4	4
Total	4	3	35	8	50

Në këtë studim u analizua lidhja midis pranisë së llojeve të ndryshme të ngarkesës mikrobiale dhe shkallës së lagështisë së zonave të dukshme të mykut në një mjedis klase, bazuar në matjet e realizuara me një detektor lagështie sipërfaqësore. Të dhënat përfshijnë praninë ose mungesën e mikroorganizmave të ndryshëm në sipërfaqe me nivele të ndryshme lagështie: sipërfaqe të thata, të lagështa, të lagura, si dhe sipërfaqe ku lagështia nuk mund të matej ose ku të dhënat mungojnë. Rezultatet tregojnë se për asnjë nga llojet mikrobiale të studiuara nuk u gjet një lidhje statistikisht e rëndësishme me shkallën e lagështisë (të gjitha P-value > 0.05). Kjo nënkupton se, në këtë grup të të dhënave, prania e baktereve të tilla si *Pseudomonas*, *Flavobacterium*, *Actinomycetes*, *Micrococcus*, *Staphylococcus* apo *Bacillus spp* nuk është në mënyrë domethënëse e lidhur me nivelin e lagështisë së sipërfaqeve të prekura nga myku.

Megjithatë, për disa mikroorganizma, si bacilet e verdha dhe Staphylococcus**,** u vu re një P-value më e ulët (0.180), që mund të tregojë një tendencë drejt një lidhjeje të mundshme, edhe pse kjo nuk është statistikisht e rëndësishme në nivelin tradicional të besueshmërisë (5%). Kjo sugjeron nevojën për studime të mëtejshme me një kampion më të madh për të verifikuar nëse ekziston realisht një marrëdhënie midis pranisë së këtyre mikrobeve dhe lagështisë së sipërfaqeve.

Në përgjithësi, këto gjetje nënvizojnë kompleksitetin e ndërveprimeve midis mikroorganizmave dhe kushteve mjedisore si lagështia, duke treguar se faktorë të tjerë të mundshëm mund të ndikojnë në shpërndarjen e ngarkesës mikrobiale në mjediset e brendshme *(shiko tabelën 9).*

Tabela 9. Lidhja midis pranisë së llojeve të ndryshme të ngarkesës mikrobiale dhe shkallës së lagështisë në zonat e dukshme të mykut në klasë

		Shkalla e lageshtise se zonave te dukshme te mykut sipas detektorit te lageshtise ne siperfaqe (klase)					**Total**	**P-value**
		Siperfaqja eshte e thate	Siperfaqja eshte e lagesht	Siperfaqja eshte e lagur	Nuk matet	Mungon		
Pseudomonas	Po	3	2	0	0	0	5	3.571/.467
	Jo	25	6	2	7	5	45	
	Total	28	8	2	7	5	50	
Flavobacterium	Po	0	1	0	0	0	1	5.357/.253
	Jo	28	7	2	7	5	49	
	Total	28	8	2	7	5	50	

	Po	1	1	0	1	0	3	
Actinomycetes	Jo	27	7	2	6	5	47	2.191/.701
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	0	1	0	0	0	1	
Baktere fijezore	Jo	28	7	2	7	5	49	5.357/.253
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	5	1	0	1	0	7	
Micrococcus	Jo	23	7	2	6	5	43	1.501/.826
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	1	0	0	0	0	7	
Aeromonas	Jo	27	8	2	7	5	49	.802/.938
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	6	2	0	0	0	8	
Bacillus spp	Jo	22	6	2	7	5	42	3.763/.439
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	1	0	0	0	0	1	
Bacillus	Jo	27	8	2	7	5	49	.802/.938
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	0	0	0	1	0	1	
Bacile te verdha	Jo	28	8	2	6	5	49	6.268/.180
	Total	28	8	2	7	5	50	
	Po	3	0	0	0	0	3	
Staphylococcus	Jo	25	8	2	7	5	47	2.508/.180
	Total	28	8	2	7	5	50	

Në këtë analizë u vlerësua lidhja ndërmjet pranisë së llojeve të ndryshme të ngarkesës mikrobiale, kryesisht kërpudhave dhe kolonive me pigmente të ndryshme, dhe shkallës së lagështisë së zonave me myk në ambientin e një klase. Lagështia u matur në sipërfaqe përmes një detektori të specializuar dhe u kategorizua në sipërfaqe të thata, të lagështa, të lagura, si dhe sipërfaqe ku lagështia nuk ishte e matur ose mungonte.

Tabela 45 analizon nëse ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme midis pranisë së llojeve të ndryshme të baktereve dhe pranisë së rrjedhjeve nga tubat e tualetit. Për çdo bakter është shënuar numri i rasteve pozitive në mjedise me ose pa rrjedhje, si dhe vlera P (P-value), e cila përcakton nëse kjo lidhje është statistikisht e rëndësishme. Asnjë nga bakteret e analizuara nuk tregoi një lidhje statistikisht të rëndësishme me rrjedhjen e tubave (të gjitha vlerat P > 0.05). *Flavobacterium***,** Baktere fijezore, dhe *Bacillus* (jo Bacillus spp) kanë vlera P afër pragut të sinjifikancës (P = .069), që sugjeron një tendencë të mundshme për lidhje**,** por kjo nuk është statistikisht e vlefshme sipas

standardit klasik (P < 0.05). Mikroorganizmat e tjerë, si *Pseudomonas, Micrococcus, Staphylococcus, Aeromonas, Bacillus spp***,** etj., shfaqin shpërndarje që nuk mbështesin ndonjë lidhje domethën*ëse* me rrjedhjet e ujit nga tualetet.

Rezultatet e Tabelës 37 tregojnë se nuk ka ndonjë lidhje statistikisht të rëndësishme midis ndonjë lloji të veçantë të bakterieve dhe pranisë së rrjedhjeve të tubave në tualet. Megjithëse disa mikroorganizma, si *Flavobacterium***,** *Bacillus***,** dhe Baktere fijezore**,** tregojnë një tendencë të mundshme për lidhje**,** këto nuk janë të mjaftueshme për të nxjerrë përfundime të forta pa më shumë të dhëna. Prandaj, bazuar në këtë analizë, prania e rrjedhjeve nuk duket të ketë ndikuar ndjeshëm në shpërndarjen e këtyre llojeve bakteriale.

Tabela 45. Lidhjet sinjifikative/ jo sinjifikative midis llojit te ngarkeses mikrobiale dhe prezences se rrjedhjes se tubave te tualetit

		A ka ndonje rrjedhje te tubave?			**Total**	**P-value**
		Po	Jo	Mungon		
Pseudomonas	Po	2	3	0	5	3.030/.220
	Jo	6	30	9	45	
	Total	8	33	9	50	
Flavobacterium	Po	1	0	0	1	5.357/.069
	Jo	7	33	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Actinomycetes	Po	1	2	0	3	1.174/.556
	Jo	7	31	9	47	
	Total	8	33	9	50	
Baktere fijezore	Po	1	0	0	1	5.357/.069
	Jo	7	33	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Micrococcus	Po	2	5	0	7	2.305/.316
	Jo	6	28	9	43	
	Total	8	33	9	50	
Aeromonas	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Bacillus spp	Po	1	5	2	8	.350/.840
	Jo	7	28	7	42	
	Total	8	33	9	50	
Bacillus	Po	1	0	0	1	5.357/.069
	Jo	7	33	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Bacile te verdha	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	

	Total	8	33	9	50	
	Po	1	2	0	3	
Staphylococcus	Jo	7	31	9	47	1.174/.556
	Total	8	33	9	50	

Tabela 46 shqyrton nëse ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis llojit të mikroorganizmave (kryesisht kërpudha dhe koloni me pigmentim të ndryshëm) dhe pranisë së rrjedhjeve në tubat e tualetit. Gjetjet kryesore: Asnjë nga mikroorganizmat e listuar nuk tregoi lidhje statistikisht të rëndësishme me rrjedhjet e tubave (të gjitha P > 0.05**).** Disa mikroorganizma, si**:** Fungi inperfekti (P = .098), Koloni të pigmentuara të verdha (P = .123), Koloni të kuqe dhe të verdha (P = .221) tregojnë tendencë për lidhje**,** por jo domethënëse në aspektin statistik. Rezultatet e tabelës 48 tregojnë se prania e rrjedhjeve nga tubat e tualetit nuk lidhet në mënyrë statistikisht të rëndësishme me asnjë nga llojet e mikroorganizmave të analizuar**.** Megjithatë, disa mikroorganizma (si Fungi inperfekti dhe kolonitë e pigmentuara) tregojnë një tendencë jo domethënëse, duke sugjeruar nevojën për studime të mëtejshme me më shumë të dhëna. Në tërësi, ngarkesa mikrobiale nuk ndikohet dukshëm nga rrjedhjet në këtë grup të analizuar. Tabela 46 shqyrton lidhjen midis disa llojeve të mikroorganizmave (kryesisht kërpudha dhe koloni të pigmentuara) dhe pranisë së rrjedhjeve në tubat e tualetit. Asnjë mikroorganizëm nuk tregoi lidhje statistikisht të rëndësishme me rrjedhjet (P > 0.05). Disa, si Fungi inperfekti (P = .098) dhe koloni të pigmentuara të verdha (P = .123), shfaqën tendencë të mundshme, por jo të vlefshme statistikisht. Nuk u konstatua lidhje domethënëse midis rrjedhjeve dhe llojeve të mikroorganizmave të analizuar.

Tabela 46. Lidhjet statistikisht sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së rrjedhjes së tubave të tualetit (n = 50)

		A ka ndonje rrjedhje te tubave?			**Total**	**P-value**
		Po	Jo	Mungon		
	Po	0	0	1	1	
Fungi inperfekti	Jo	8	33	8	49	4.649/.098
	Total	8	33	9	50	
	Po	0	3	0	3	
Cladosporium	Jo	8	30	9	47	1.644/.440
	Total	8	33	9	50	
	Po	0	1	0	1	
Alternaria	Jo	8	32	9	49	.526/.769
	Total	8	33	9	50	
	Po	3	14	1	18	3.019/.221

Koloni te pigmentuara -te kuqe dhe te verdha	Jo	5	19	8	32	
	Total	8	33	9	50	
Koloni te pigmentuara -te verdha	Po	0	7	0	7	
	Jo	8	26	9	43	4.193/.123
	Total	8	33	9	50	
Koloni te ndryshme	Po	1	1	0	2	
	Jo	7	32	9	48	1.961/.375
	Total	8	33	9	50	
Koloni te ndryshme, pak te pigmentuara	Po	0	1	0	1	
	Jo	8	32	9	49	.526/.769
	Total	8	33	9	50	
Koloni te pigmentuara	Po	0	1	0	1	
	Jo	8	32	9	49	.526/.769
	Total	8	33	9	50	
Koloni baktere te pigmentuara -bacile gr+ te verdha	Po	2	3	2	7	
	Jo	6	30	7	43	1.970/.373
	Total	8	33	9	1	
Koloni baktere te pigmentuara te bardha	Po	1	2	0	3	
	Jo	7	31	9	47	1.174/.556
	Total	8	33	9	50	

Tabela 47 analizon nëse ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme midis pranisë së llojeve të caktuara mikrobiale (kryesisht kërpudha dhe maja) dhe rrjedhjeve në tubat e tualetit. Vetëm një mikroorganizëm, *Candida spp***,** tregoi lidhje statistikisht të rëndësishme me rrjedhjet e tubave (P = .009**).** Kjo sugjeron që *Candida spp* mund të jetë më e pranishme në mjedise ku ka rrjedhje uji, ndoshta për shkak të lagështisë më të lartë që favorizon zhvillimin e saj. Nga të gjitha mikroorganizmat e shqyrtuar në këtë tabelë, vetëm *Candida spp* ka një lidhje të rëndësishme me rrjedhjet e tubave të tualetit**,** duke sugjeruar ndjeshmëri ndaj kushteve të lagështa.Për mikroorganizmat e tjerë, nuk u gjetën lidhje domethënëse, dhe prania e tyre duket të jetë e shpërndarë në mënyrë të rastësishme, pa ndikim të drejtpërdrejtë nga rrjedhjet.

Tabela 47. Lidhjet statistikisht sinjifikative/jo sinjifikative midis llojit të ngarkesës mikrobiale dhe pranisë së rrjedhjeve të tubave të tualetit (n = 50)

		A ka ndonje rrjedhje te tubave?			**Total**	**P-value**
		Po	Jo	Mungon		
Koloni baktere te pigmentuara te kuqe	Po	0	0	1	1	
	Jo	8	33	8	49	4.649/.098
	Total	8	33	9	50	
Aspergillus	Po	0	3	0	3	1.644/.440

	Jo	8	30	9	47	
	Total	8	33	9	50	
Candida spp	Po	0	0	2	2	9.491/.009
	Jo	8	33	7	48	
	Total	8	33	9	50	
Penicillium spp	Po	2	12	3	17	.373/.830
	Jo	6	21	6	33	
	Total	8	33	9	50	
Mucor spp	Po	2	13	5	20	1.662/.436
	Jo	6	20	4	30	
	Total	8	33	9	50	
Rhisopus nigricans	Po	0	3	2	5	2.413/.299
	Jo	8	30	7	45	
	Total	8	33	9	50	
Aspergillu spp	Po	2	9	5	16	2.814/.245
	Jo	6	24	4	34	
	Total	8	33	9	50	
Mucor hiemalis	Po	1	2	0	3	1.174/.556
	Jo	7	31	9	47	
	Total	8	33	9	50	
Mucor mucedo	Po	1	1	0	2	1.961/.375
	Jo	7	32	9	48	
	Total	8	33	9	50	
Baktere e maja te pigmentuara	Po	1	1	0	2	1.961/.375
	Jo	7	32	9	48	
	Total	8	33	9	50	

Tabela 48 tregon se nuk ka lidhje statistikisht të rëndësishme midis pranisë së rrjedhjeve të tubave të tualetit dhe llojeve të ndryshme të ngarkesës mikrobiale të analizuar. Asnjë nga kolonitë bakteriale apo kërpudhave të përfshira, si Bacile gram-pozitive, Cladospora, Alternaria, Penicillium crysogenum apo të tjera, nuk tregoi ndikim të rëndësishëm statistikisht në lidhje me rrjedhjet e tubave (p-vlerat janë mbi 0.05). Kjo tregon se prania e këtyre mikroorganizmave nuk është e lidhur drejtpërdrejt me rrjedhjet në tubat e tualetit në mostrat e studiuara.

Tabela 48. Lidhjet sinjifikative/ jo sinjifikative midis llojit te ngarkeses mikrobiale dhe prezences se rrjedhjes se tubave te tualetit

		A ka ndonje rrjedhje te tubave?			**Total**	**P-value**
		Po	Jo	Mungon		
Koloni bakteresh -bacile gr+	Po	0	0	1	1	4.649/.098
	Jo	8	33	8	49	

	Total	8	33	9	50	
Koloni bakteresh te verdha	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Cladospora	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Cladospora spp	Po	1	3	1	5	.098/.952
	Jo	7	30	8	45	
	Total	8	33	9	50	
Alternaria spp	Po	1	2	0	3	1.174/.556
	Jo	7	31	9	47	
	Total	8	33	9	50	
Endomycopsis spp	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Rhodotorula/	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	
	Total	8	33	9	50	
Trichoderma viride	Po	0	0	1	1	4.649/.098
	Jo	8	33	8	49	
	Total	8	33	9	50	
Penicillium crysogenum	Po	0	0	1	1	4.649/.098
	Jo	8	33	8	49	
	Total	8	33	9	50	
Basidiomycete-aureobasidie	Po	0	0	1	1	4.649/.098
	Jo	8	33	8	49	
	Total	8	33	9	50	
Bisociamus fulva	Po	0	0	1	1	4.649/.098
	Jo	8	33	8	49	
	Total	8	33	9	50	
Saccharomycopsis spp	Po	0	0	1	1	4.649/.098
	Jo	8	33	8	49	
	Total	8	33	9	50	
Aureobazidium spp	Po	0	1	0	1	.526/.769
	Jo	8	32	9	49	
	Total	8	33	9	50	

Këto rezultate tregojnë analizën multivariate të ndikimit të variablave të studiuar mbi ngarkesën mikrobiale. Testet e ndryshme multivariate (Pillai's Trace, Wilks' Lambda, Hotelling's Trace, dhe Roy's Largest Root) japin vlera të njëjta dhe tregojnë se nuk ka një efekt statistikorisht të rëndësishëm të variablave mbi ngarkesën mikrobiale ($p = 0.114$). Kjo do të thotë se, në këtë analizë, ndryshimet midis grupeve nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar një ndikim të qartë.

Vlera e Partial Eta Squared prej 0.785 tregon një efekt mesatar deri të fortë, por që nuk arrin të jetë statistikisht i rëndësishëm në këtë rast. Në përgjithësi, rezultatet sugjerojnë mungesë të një ndikimi të qartë të variablave të testuar mbi ngarkesën mikrobiale në mostrat e marra *(shiko tabelen 49).*

Tabela 49. Rezultatet e testit MANOVA për ndikimin e variablave në ngarkesën mikrobiale

Testi	Vlera	F	df (Hypothesis)	df (Error)	p-value	Partial Eta Squared
Pillai's Trace	0.785	1.766	33	16	0.114	0.785
Wilks' Lambda	0.215	1.766	33	16	0.114	0.785
Hotelling's Trace	3.642	1.766	33	16	0.114	0.785
Roy's Largest Root	3.642	1.766	33	16	0.114	0.785

Analiza tregon se prania e Candida spp ka një efekt statistikorisht të rëndësishëm mbi variablën e studiuar ($F = 5.68$, $p = 0.021$). Vlera e Partial Eta Squared prej 0.106 tregon që Candida spp shpjegon rreth 10.6% të ndryshimeve në variablën e analizuar, duke treguar një ndikim me madhësi mesatare. Kjo do të thotë se Candida spp është një faktor i rëndësishëm që ndikon në rezultatet e studimit.

Tabela 50. Rezultatet e analizës së variablës Candida spp dhe ndikimit të saj

Variabla	F	p-vlera	Partial Eta Squared
Candida spp	5.68	0.021	0.106

Testet multivariat (Pillai's Trace, Wilks' Lambda, Hotelling's Trace dhe Roy's Largest Root) tregojnë një efekt të përgjithshëm të rëndësishëm statistikisht me një p-vlerë prej 0.035. Vlerat e F (2.362) dhe Partial Eta Squared (0.830) tregojnë se modeli shpjegon një pjesë të madhe të variacionit në të dhëna (rreth 83%). Kjo tregon se variablat e përfshirë në model kanë një ndikim të rëndësishëm multivariat në rezultatet e studimit.

Tabela 51. Rezultatet e Testeve Multivariat për Ndikimin e Variablave në Model

Testi	Vlera	F	df (Hypothesis)	df (Error)	p-value	Partial Eta Squared
Pillai's Trace	0.830	2.362	33	16	0.035	0.830
Wilks' Lambda	0.170	2.362	33	16	0.035	0.830
Hotelling's Trace	4.871	2.362	33	16	0.035	0.830
Roy's Largest Root	4.871	2.362	33	16	0035	0.830

Variablat “Koloni të pigmentuara – të kuqe dhe të verdha” dhe “Rhodotorula spp” tregojnë ndikim të rëndësishëm statistikisht mbi rezultatet e matjes. Përkatësisht, Kolonitë e pigmentuara kanë një vlerë F prej 4.033 me p-vlerë 0.050, duke treguar një lidhje në kufirin e rëndësishëm, dhe shpjegojnë rreth 7.8% të variabilitetit në të dhëna. Rhodotorula spp ka ndikim më të fortë me një vlerë F prej 8.183 dhe p-vlerë 0.006, duke shpjeguar 14.6% të variacionit, që tregon një lidhje statistikorisht të rëndësishme dhe më të fortë. Këto rezultate nënvizojnë rëndësinë e këtyre dy mikrobeve në analizën e studimit.

Tabela 52. Rezultatet e analizës së variablave në lidhje me ngarkesën mikrobiale dhe ndikimin e tyre statistik

Variabla	F	p-vlera	Partial Eta Squared
Koloni te pigmentuara-te kuqe dhe te verdha	4.033	0.050	0.078
Rhodotorula spp	8.183	0.006	0.146

Gjetjet në rrethet e Shqipërisë

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë lidhur me ngarkesën mikrobike në ajrin e shkollave fillore në qytetin e **Korçës,** u vu re një prani e ndryshueshme e kolonive bakteriale në mediat kultivuese PCA dhe CAPEK pas 48 orësh inkubimi. Koloni me pigmentim të kuq dhe të verdhë u identifikuan në të gjitha shkollat, duke sugjeruar praninë e mikroorganizmave të ndryshëm, përfshirë edhe forma potencialisht oportuniste.

Shkollat “Demokracia” dhe “Ismail Qemali” paraqitën numrin më të lartë të kolonive në të dyja llojet e mediave, duke treguar një nivel më të lartë të ndotjes mikrobike të ajrit në këto ambiente. Në kontrast, shkolla “Th. Germenji” shfaqi vlera përgjithësisht më të ulëta, çka mund të lidhet me kushte më të mira higjieno-sanitare ose me ventilim më efikas të ambienteve.

Media PCA, e cila favorizon rritjen e baktereve të përgjithshme, tregoi një ngarkesë mikrobike më të lartë krahasuar me median CAPEK, e cila është selektive për organizma specifikë, duke reflektuar kështu diversitetin mikrobik të pranisë bakteriale në mjedisin shkollor. Dallimet ndërmjet vlerave në dy llojet e mediave për secilin kampion sugjerojnë variabilitet në ekspozimin

mikrobik, i cili mund të ndikohet nga faktorë si numri i nxënësve në klasë, frekuenca e pastrimit dhe ventilimi.

Prania e qëndrueshme e kolonive me pigmentim të kuq dhe të verdhë në shumicën e kampioneve tregon një mikrobiotë tipike mjedisore, e cila megjithatë kërkon monitorim për të shmangur ekspozimin e zgjatur të nxënësve ndaj ndotësve biologjikë (tab. 53).

Tabela 53. Ngarkesa mikrobike në pesë shkolla fillore të qytetit të Korçës

Shkolla	**Terreni**	**Koloni në pjate**	**Shënime**	**Koloni ne pjatë (pas 48 orësh)**	**Shënime**
DEMOKRACIA	PCA-1	113 (mes. 109)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	120 (mes.122)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	PCA-2	104	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	124	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-1	47 (mes. 53)		47	
	CAPEK-2	59	Koloni te pigment- te verdha	59	Koloni te pigment-te verdha
N. VEQILHARXHI	PCA-1	78 (mes. 78)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	80 (mes. 82)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	PCA-2	78	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	84	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-1	39 (mes. 43)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	39 (mes. 43)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-2	46	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	46	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
TH. GERMENJI	PCA-1	29 (mes. 36)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	29 (mes. 36)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	PCA-2	43	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	43	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-1	29 (mes. 30)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	29 (mes. 30)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-2	30	Koloni te pigment- te verdha	30	Koloni te pigment-te verdha
NAIM FRASHERI	PCA-1	59 (mes. 57)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	62 (mes. 63)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	PCA-2	55	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	64	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-1	17 (mes. 23)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	17 (mes. 23)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-2	28	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	28	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
ISMAIL QEMALI	PCA-1	89 (mes. 95)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	89 (mes. 95)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha

	PCA-2	100	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	100	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-1	23 (mes. 12)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	23 (mes. 12)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
	CAPEK-2	1	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	1	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha

Figura 1 paraqet në mënyrë grafike shpërndarjen e ngarkesës mikrobike të izoluar nga shkollat e rrethit të Korçës, bazuar në numrin e kolonive të mikroorganizmave të rritura në pjata Petri pas 48 orësh inkubimi në media të ndryshme kultivuese.

Vërehet se ngarkesa mikrobike është më e lartë në median PCA, siç tregohet nga prania dominuese e ngjyrës blu, duke sugjeruar një përqendrim të shtuar të baktereve totale në ambientet shkollore. Ngjyra e kuqe, që përfaqëson ngarkesën mikrobike pas 48 orësh, në disa raste tejkalon ngarkesën fillestare, duke reflektuar mundësisht përkeqësim të kushteve mjedisore ose rritje të aktivitetit njerëzor brenda ambienteve. Ndërkohë, ngjyra jeshile, që tregon ngarkesën në median CAPEK ku mbizotërojnë kërpudhat, paraqitet në nivele më të ulëta krahasuar me PCA, por mbetet e pranishme në të gjitha shkollat, duke sinjalizuar një kontaminim të vazhdueshëm nga kërpudhat në mjediset shkollore.

Këto rezultate tregojnë se ajri i brendshëm në institucionet arsimore përmban një ngarkesë të konsiderueshme mikrobike, e cila mund të paraqesë rrezik për shëndetin e fëmijëve në mungesë të masave të përshtatshme higjieno-sanitare dhe ventilimit.

Figura 1. Paraqitje grafike e numrit të ngarkesave mikrobike të izoluara në shkollat e rrethit të Korçës (numri i mikroorganizmave për pjatë Petri).





Figura 2. Qarkullimi indoor/outdoor & ekspozimi i njerëzve ndaj tyre



Figura 3. Shpërndarja e ngarkesave indoor & formimi i biofilmave dhe bioaerosoleve në ajër



Për të bërë një krahasim me studime bashkëkohore të kësaj fushe, më poshtë janë paraqitur pamje të kytere studimeve për të bërë krahasimet me ngarkesat tona. Në studime të ngjashme, (figura 5) shihet qartë që ka ngjashmeri të spikatur me pamjet epërftuara në shkollat Naum Veqilharxhi dhe Themistokli Germenji , ku në të dy rastet bakteret dhe majatë e pigmentuara janë në num,ur të kon

siderueshëm. Nga krahasimi i figures 4 me myqet e gjetura ne terrenin Capek ka dominance te gjinise dhe specieve *Aspergillus.*

Figura 4. Pamje të përftuara nga studime në fushën e ndotjes mikrobiologjike te ajrit *(www.vecteezy.com)*




Figura 5. Ngarkesa mikrobiologjike në ajër nga studimet bashkëkohore
Majtas: *arinspiredpencil.com*
Djathtas: *bioaerosole indoor*
https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Common_Bioaerosol_Isolated_From_Indoor_Environments.JPG




Figura 6. Ngarkesa mikrobiologjike në ajër nga studimi ynë (shkolla NV-Korçë)






Figura 7. Ngarkesa mikrobiologjike në ajër nga studimi ynë (shkolla Th.G.-Korçë)



Nga vështrimi mikroskopik i kolonive tona të izoluara (figura 6), me një ngjashmëri shumë të madhe me figurën e studimeve analoge (figura 7), kolonitë e verdha janë bacile të zhvilluara dobët, kurse kolonitë e kuqe janë maja të grupit të *Rhodotorulave*, pra *Rhodotorula specie*. Kolonitë e vogla, të kuqe, të dallueshme për nga morfologjia, pamja dhe siperfaqja e kolonive si dhe të diferencuara mikroskopikisht nga majatë *Rhodotorula spp.,* në figurat 4 dhe 5, janë baktere, me shumë mundësi të gjinisë *Serratia marcescens*, të cilat i përkasin gjinisë *Yersiniaceae*. Nga vrojtimi mikroskopik dhe ngjyrosja sipas Gramit janë Gr. negative. Kjo na bën të besojmë se i

përkasin këtij grupi. Janë shume të përhapura si ndotës tipikë mjedisorë, bile në mjedise spitalesh vijnë nga plagët apo mikroorganizmat e kateterëve, kur mbahen gjatë dhe pa ndërruar, pas operacionit apo sëmundjeve në veshka. Nga aty, ato shperhapen në ajër. Nga studimet e bëra janë edhe ngarkesa të lidhura me bimësitë zonale. Konsiderohen fakultative anaerobe, qe kanë një pathogjenicitet të dobët, pasi në shumë raste mund të prekin traktin respirator apo të prekin sytë duke shkaktuar konjuktivite, keratite apo lotë në sy. Ka raste që nga mjedisi ato merren dhe krijojnë biofilma në dhëmbë, duke prodhuar një prodigiozinë- tripirol me ngjyrë të kuqe në portokalli, që mund të shkaktojë një prekje të ngjyrës natyrore të dhëmbit, duke u vendosur edhe në xhenxhivat. Në natyrë izolohet nga qoshe të mjediseve të populluara, (sikurse mostrat tona), nga banjat, dushet, tubacionet dhe siperfaqet e tyre, etj.. Tripiroli karakteristik i *Serratias* paraqitet në figurën 8.

Figura 8. Prodigiozina, kolonitë e zhvilluara dhe tretësira e përqëndruar e prodigiozinës së pastër në etanol sipas www.researchgate.net



Sikurse shihet edhe nga formula më sipër, prodigiozina është ngjyrë, ka tre unaza piroli dhe sot mikroorganizmat e *Serratia spp*. përdoren për prodhimin e saj.

Prania e majave në ajër përgjithësisht është shumë më e vogël se e baktereve dhe myqeve, por dominanca në këtë rast e kolonive të kuqe-maja, në shkolla me distancë njëra nga tjetra, patjetër

është e lidhur më bimësinë zonale, pemët e mbjella dhe karakteristikat specifike klimatike të këtij rajoni juglindor. Kjo lidhet me faktin që këto maja të pigmentuara në të kuq kanë aftësi të kolonizojnë bimët në mjediset ku janë identifikuar. Gjithashtu gjenden në tubacione, mjedise indoor si banja, dushe, mjedise spitalore dhe sikurse bakteret e pigmentuara, pathogjeniciteti i tyre lidhet edhe me sëmundjet që shkaktojne në sy. Vlen të theksohet që shumë herë formojnë biofilma në materiale plasike dhe kur këto materiale bëhen hedhurina, mundësia e ndotjes së ajrit prej tyre është e madhe. Nga ana bioteknologjike këto specie kanë rëndësi sepse janë prodhuese të karotenoideve, triglicerideve dhe acideve yndyrore e vajrave. Pra, *Rhodotorulat* në dallim nga *Serratia-t* prodhojnë karotenoidet, kurse *Serratia* prodigiozinën.

Sugjerohet që në të ardhmen, të krijohet mundësia e një kërkimi shkencor lidhur me këto koloni të pigmentuara, duke bërë një studim të mjedisit rrethues outdoor dhe pemëve për rreth. Sikurse shihet nga numuri i evidentuar i mikroorganizmave, pastërtia e shkollave, oborrit, gjelbërimi, higjiena personale dhe kolektive janë faktorët ndikues dominantë në rezultatet e paraqitura më sipër.

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 54 ilustrojnë praninë dhe përqindjen e ngarkesës mykotike në pesë shkolla të qytetit të Korçës, të kultivuara në median CAPEK. Rezultatet tregojnë se përqindja e kërpudhave brenda ngarkesës totale mikrobike ndryshon ndjeshëm ndërmjet shkollave, duke reflektuar diferenca në kushtet mjedisore dhe higjieno-sanitare.

Shkolla "Ismail Qemali" paraqet përqindjen më të lartë të kërpudhave me 41.6%, e ndjekur nga "Th. Germenji" me 33.3%, ndërsa "Naim Frashëri" shfaq përqindjen më të ulët, vetëm 13.0%.

Gjinat dominante të identifikuara përfshijnë specie të zakonshme si *Penicillium spp.*, *Mucor spp.*, *Aspergillus spp.*, si dhe forma të papërsosura të kërpudhave (*Fungi imperfecti*). Prania e lartë e këtyre mikroorganizmave, të njohur për potencialin e tyre alergjik dhe toksik, mund të përbëjë rrezik për shëndetin respirator të nxënësve dhe stafit, veçanërisht në kushte ventilimi dhe higjiene të pamjaftueshme. Variacionet ndërmjet shkollave mund të lidhen me faktorë lokalë si lagështia, ngarkesa e ajrit të brendshëm, frekuenca e pastrimit dhe ventilimi, duke theksuar domosdoshmërinë e monitorimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të kushteve mjedisore në shkolla.


Tabela 54. Rezultatet e ngarkesës mykotike në pesë shkolla fillore të qytetit të Korçës.

Shkolla në Korçë	Terreni	Koloni në pjatë	Shënime

			(myqe ne perqindje te ngarkesave totale dhe llojet dominante)
DEMOKRACIA	CAPEK-1	47 (mes. 53), (12 myqe)	22.6% myqe- *Fungi imperfecti, Aspergillus terreus, Penicillium spp.*
	CAPEK-2	59	Koloni te pigment- te verdha
N. VEQILHARXHI	CAPEK-1	39 (mes. 43), (8 myqe)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha 18.6% myqe- *Fungi imperfecti, Aspergillus terreus, Penicillium spp.*
	CAPEK-2	46	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
TH. GERMENJI	CAPEK-1	29 (mes. 30) (10 myqe)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha 33.3% myqe-*Mucor spp., Penicillium spp.*
	CAPEK-2	30	Koloni te pigment- te verdha
NAIM FRASHERI	CAPEK-1	17 (mes. 23) (3 myqe)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha 13.0% -*Mucor spp, Penicillium spp., Rhizopus nigricans*
	CAPEK-2	28	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha
ISMAIL QEMALI	CAPEK-1	23 (mes. 12) (5 myqe)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha 41.6%myqe-*Aspergillus spp. Mucor hiemalis, Mucor spp., Penicillium spp.*
	CAPEK-2	1	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha


Sikurse shihet nga grafiku i figurës 9 ngarkesa më e madhe në pjatë, por larg limitit risk, është në shkollat Demokracia dhe Naum Veqilharxhi. Ajo që vlen të theksohet është fakti që edhe në këto raste ngarkesa i përket rreth 4 llojeve të mikroorganizmave. Pra ka një numër më të madh, por jo më shumë lloje mikroorganizmash. Vrojtuar si pëqindje ngarkesash mykore, krahasuar me ngarkesën e përgjithëshmë në terrenin Capek, ngarkesa më e madhe respektivisht 41.6% dhe 33.3% është në shkollat Ismail Qemali dhe Themistokli Germenji.

Figura 9. Ngarkesat totale ne CAPEK (mikroorganizma ne pjate Petri) në mostrat e marra në shkollat e Korçës, krahasuar me ngarkesat mykore në të njejtin terren.
Ngjyra blu- ngarkesat në CAPEK
Ngjyra portokalli- ngarkesat mykore në CAPEK



Nuk ka ndonjë faktor të vecantë për këtë rritje krahasuar me shkollat e tjera, vetëm mund t'i atribuohet bimësisë përrreth (Figura 10).

Figura 10. Ngarkesat mykore në përqindje në mostrat e marra në shkollat e Korçës, krahasuar me ngarkesat totale në Capek.



Të dhënat për shkollat e **Vlorës** tregojnë nivele të ndryshme të ngarkesës mikrobike dhe përqindjes së pranisë së kërpudhave në ambientet shkollore, të vlerësuara përmes përdorimit të mediave kultivuese PCA dhe CAPEK. Mesatarisht, ngarkesa bakteriale ishte më e lartë në median PCA,

me koloni të pigmentuara kryesisht në të kuqe dhe të verdhë, ndërsa media CAPEK evidentoi ngarkesën mykotike, duke identifikuar një numër të konsiderueshëm kërpudhash në të gjitha shkollat.

Kontrolli mikrobiologjik outdoor/indoor në Vlorë u realizua me dy grupe eksperimentesh. Në grupin e parë u bë përcaktimi i ngarkesave në ajër në shkollat Rilindja, 28 Nëntori, 4 Heronjtë, Ali Demi, Muço Delo dhe Teli Ndini. Tre të parat ishin të gjitha në zonën e Bashkisë Vlorë me shumë popullsi dhe me një bimësi mesatare.

Në figurat më poshtë paraqiten mjediset e shkollave Ismail Qemali, Pilo Prifti-Novoselë, Halim Xhelo dhe Jani Minga.

Foto 1, 2. Shkolla Ismail Qemali –Vlorë

Vëndet ku u bë mostrimi në oborr dhe koridor.





Foto 3. Shkolla Halim Xhelo –Vlorë

Vëndi ku u bë mostrimi në oborr.



Foto 4, 5. Shkollat Jani Minga –Vlorë dhe Pilo Prifti-Novoselë

Vëndet ku u bë mostrimi në oborr.





Eksperimenti u realizua në një kohë normale me një temperature rreth 20 gradë C, me pak erë, e cila stimulonte përhapjen e ngarkesave, gjithmonë me të njëjtat kushte të vendosjes së pjatave të Petrit (shi mikrobik në sipeëfaqe $1m^2$ nga hyrja, pozicionim 90 cm lartësi dhe në kohën e daljes së nxënësve). Tre shkollat e para afër njëra tjetrës dhe në të njejtin pozicion gjeografik, dy shkollat e tjera më larg dhe në zonë të populluar edhe ato.

Në tabelën 55 paraqiten ngarkesat e vlerësuara në grupin e parë të eksperimenteve në shkollat e Vlorës. Sikurse shihet, ngarkesat totale janë të gjitha në rendin 10^2, por pa arritur limitin e numrit të riskut. Ngarkesat e përgjithshme ne Capek janë të rendit 10^1 dhe ngarkesa më e vogël është në shkollën 4 Heronjtë - vetëm 7 mikroorganizma të zhvilluara dhe të kontrolluara si numër deri në 7 ditë.


Nga ana tjetër, shkollat "4 Heronjtë" dhe "Muço Delo" paraqitën përqindjet më të larta të kërpudhave brenda ngarkesës totale mikrobike, me 85.7% dhe 34.6% respektivisht, duke treguar një dominim të theksuar të mikroorganizmave mykotikë në këto ambiente. Shkollat "Ali Demi" dhe "Teli Ndini" shfaqën ngarkesë totale bakteriale më të lartë në median PCA, por me përqindje më të ulët të kërpudhave, ndërsa në shkollat "Teli Ndini" dhe "4 Heronjtë", prania e kërpudhave në median CAPEK arriti deri në 85.7%, duke sinjalizuar një prani të vazhdueshme të sporeve mykotike në ajër.

Tabela 55. Rezultatet nga pesë shkolla fillore në qytetin e Vlorës (numri mesatar i kolonive për pjatë Petri)

Shkollat në Vlorë	**Terreni**	**Koloni në pjatë**	**Shënime**	**Koloni në pjatë**	**Shënime** *(myqe ne perqindje te ngarkesave totale dhe llojet dominante)*
RILINDJA	PCA	103	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	CAPEK	27	Koloni te ndryshme, pak te pigmentuara	27 **(5 myqe)**	**18.5% myqe-** *Mucor spp.*
28 NENTORI	PCA-1	104	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	CAPEK	36	Koloni te ndryshme	36 **(11myqe)**	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha **30.5% myqe-** *Mucor spp.Mucor mucedo, Aspergillus terreus*
4 HERONJTE	PCA-1	101	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	CAPEK	7	Koloni te ndryshme	7 **(6 myqe)**	**85.7% myqe-***Mucor spp., Aspergillus terreus*
ALI DEMI	PCA-1	117 (mes. 92)	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	PCA-2	66	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	CAPEK-1	23 (mes. 33)	Koloni te ndryshme	23 **(9 myqe) (mes. 33) (mes myqe 9)**	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha **27.7% myqe-***Mucor hiemalis, Mucor mucedo, Aspergillus spp.*
	CAPEK-2	43	Koloni te ndryshme	43 **(8 myqe)**	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha **18.6 % myqe-** *Mucor spp, Aspergillus niger, Aspergillus terreus*
MUÇO DELO	PCA	106	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	CAPEK	26	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha	26 **(9 myqe)**	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha **34.6%myqe-***Aspergillus terreus me shumice dhe Candida spp.*
TELI NDINI	PCA	111	Koloni te pigment-te kuqe dhe te verdha		
	CAPEK	15	Koloni te ndryshme, pak te pigmentuara	15 **(2 myqe)**	Koloni te pigment. te verdha dhe te kuqe **13.3%myqe-** *Aspergillus niger, Mucor spp.*

Figura 11 paraqet në mënyrë grafike ngarkesën mesatare mikrobike të izoluar nga shkollat në Vlorë, duke krahasuar rezultatet e marra në mediat PCA dhe CAPEK pas 48 orësh inkubimi.
Ngjyra blu, që përfaqëson ngarkesën bakteriale në median PCA, tregon vlera dukshëm më të larta në të gjitha shkollat krahasuar me ngjyrën e kuqe, e cila tregon ngarkesën mykotike në median CAPEK. Ky diferencim demonstron se ngarkesa bakteriale është më e lartë dhe më e përhapur në ajrin e brendshëm të ambienteve shkollore, ndërsa kërpudhat, megjithëse të pranishme në përqindje më të ulëta, evidentohen në mënyrë të konsiderueshme, veçanërisht në shkollat "28 Nëntori", "Muço Delo" dhe "Ali Demi".
Kjo shpërndarje e ngarkesave mikrobike sugjeron një ndotje biologjike të vazhdueshme në ambientet e brendshme, ku si bakteret ashtu edhe kërpudhat mund të përbëjnë rrezik për shëndetin respirator të nxënësve, sidomos në kushte ventilimi të pamjaftueshëm ose higjiene të dobët.
Rezultatet theksojnë nevojën për monitorim të rregullt të cilësisë së ajrit dhe ndërhyrje që synojnë përmirësimin e kushteve mjedisore në shkolla.

Figura 11. Paraqitje grafike e numrit të ngarkesave mikrobike të izoluara nga shkollat në Vlorë (numri mesatar i mikroorganizmave për pjatë Petri).




Speciet më të izoluara përfshinin *Mucor spp.*, *Mucor mucedo*, *Aspergillus terreus*, *Aspergillus niger* dhe, në disa raste, *Candida spp.*, të cilat janë mikroorganizma oportunistë potencialisht të dëmshëm në kushte të pafavorshme mjedisore. Nga vrojtimi i ngarkesës mykore evidentohet një dominancë e gjinisë *Mucor*, në të gjitha shkollat rrotull Bashkisë. Eshte identifikuar kryesisht me mikroskopi dhe pjesën e mbrapme të kolonisë prania e *Mucor hiemalis*. *Mucor hiemalis* bën pjesë

në rendin *Mucorales* të myqeve që formojnë zygospora. Ai është një myk i rëndësishëm, pasi rendi ku bën pjesë ka myqe me rëndësi industriale në proçeset biotransformuese dhe në prodhimin farmaceutik. Myqet e gjinisë *Mucor* kanë sporangiofora të gjata dhe me përhapje shumë të madhe, gjë që u vu re edhe në pjatat tona ku brenda 48 oresh, 75 % e pjatave ishte e mbuluar nga sporangioforat. Prania e myqeve të gjinisë *Mucor* është e lidhur kryesisht me praninë në ushqime. Materialet ushqimore hedhurinë janë burim i pranisë së kësaj gjinie në ajër, ku sporangiosporat luajnë rolin kryesor përhapës. Gjatë numurimit të mikroorganizmave në pjata Petri u identifikuan 2 lloj *Mucoresh*, *Mucor hiemalis* dhe *Mucor mucedo,* të dyja me diferencë vetëm në dendurinë e sporangiosporave. *Mucor mucedo* është shumë i pranishëm në bimësi, në ushqime bimore, kryesht zarzavate dhe që aty kalon me shpejtesi në ajër. Prania e tyre ishte evidente në të njejtën zone ku funksionojne shkollat më sipër.

Figura 12 ilustron ngarkesat totale mikrobike të izoluara në median CAPEK nga mostrat e mbledhura në shkollat e Vlorës, duke dalluar midis ngarkesës së përgjithshme mikrobike dhe komponentit mykotik.


Ngjyra blu përfaqëson numrin total të mikroorganizmave, ndërsa ngjyra me te kuqe tregon përqindjen e kërpudhave brenda këtyre ngarkesave. Rezultatet theksojnë se në disa shkolla kërpudhat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës totale mikrobike, duke reflektuar një nivel të dukshëm të kontaminimit mykotik në ambientet shkollore. Kjo situatë sugjeron një prani të vazhdueshme të sporeve të kërpudhave në ajrin e brendshëm, e cila mund të ndikojë negativisht në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin respirator të nxënësve dhe stafit. Këto gjetje theksojnë domosdoshmërinë e masave efektive të monitorimit dhe kontrollit për menaxhimin e ndotjes biologjike në institucionet arsimore.

Figura 12. Ngarkesat totale ne CAPEK (mikroorganizma në pjatë Petri) në mostrat e marra në shkollat e Vlorës (grupi i parë), krahasuar me ngarkesat mykore në të njejtin terren.
Ngjyra blu- ngarkesat në CAPEK
Ngjyra e kuqe - ngarkesat mykore në CAPEK.



Nga grafiku i Figurës 13 shihet qartë një dominancë e myqeve në nivelet 85.7% në shkollën 4 Heronjtë.

Figura 13. Ngarkesat mykore në perqindje në mostrat e marra në shkollat e Vlorës (grupi pare), krahasuar me ngarkesat totale ne Capek.



Për të sqaruar nga ana morfologjike myqet e izoluara dhe identifikuara shërben edhe informacioni i ilustruar me poshte për myqet e gjinise *Mucor*, të cilat dominonin ngarkesat e tjera mykore.

Foto 6. Gjinia *Mucor* dhe përhapja përmes sporangiosporave**.** *Viquipedia, encyclopedia iliure*



Foto 7. Specia *Mucor mucedo* marrë nga *James Lindsey at Ecology of Commanster*



Foto 8. Specia *Mucor mucedo* me riprodhim aseksual, e rritur ne domate, marrë nga *Sciencefotolibrary*



Specia *Mucor mucedo*, e cila ka një dominim në ngarkesat e evidentuara mykore është cilësuar si një pathogjen bimor që gjendet shumë në zona të populluara, toka, mjedise të lagështa me vlera të larta, si dhe në ushqime me lagështirë apo ushqime të dëmtuara. Gjina e dytë e myqeve, e evidentuar ishte gjinia *Aspergillus*: speciet *Aspergillus terreus* dhe *Aspergillus niger*, me përhapje pothuaj në të gjitha pjatat dhe e shoqëruar edhe nga prania e majasë *Candida spp*., kjo vlerësuar si pathogjene dhe shkaktare e kandidozave.

Pozitiv është fakti që në mjediset e populluara me sipër, nuk është evidentuar në asnje rast prania *Blastomyces dermatitidis,* nje myk qe shkakton blastomykoze, infeksion këpurdhor serioz në lëkurë dhe në fyt, përmes thithjes nga ajri apo depozitimit në lëkurë. Për ta dalluar: ky myk nga *Aspergillus niger* ka pothuaj të njëjtën madhësi dhe formë kolonie por që ndryshon nga ngjyra dhe është paraqitur në Foton 9.

Foto 9. *Blastomyces dermatitidis* marre nga *depositphotos*



Figura 14 ilustron ngarkesat totale mikrobike të izoluara në median CAPEK nga mostrat e mbledhura në shkollat e Vlorës (grupi 1), duke dalluar midis ngarkesës së përgjithshme mikrobike dhe komponentit mykotik.

Ngjyra blu përfaqëson numrin total të mikroorganizmave, ndërsa ngjyra e kuqe tregon përqindjen e kërpudhave brenda këtyre ngarkesave. Rezultatet theksojnë se në disa shkolla kërpudhat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës totale mikrobike, duke reflektuar një nivel të dukshëm të kontaminimit mykotik në ambientet shkollore. Kjo situatë sugjeron një prani të vazhdueshme të sporeve të kërpudhave në ajrin e brendshëm, e cila mund të ndikojë negativisht në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin respirator të nxënësve dhe stafit dhe theksojnë domosdoshmërinë e masave efektive të monitorimit dhe kontrollit për menaxhimin e ndotjes biologjike në institucionet arsimore.

Figura 14. Ngarkesat totale mikrobike në median CAPEK (mikroorganizma për pjatë Petri) në mostrat e mbledhura nga shkollat në Vlorë (grupi 1).





Figura 15 paraqet në mënyrë grafike përqindjen e ngarkesës mykotike në mostrat e mbledhura nga shkollat në Vlorë (Grupi 1), duke i krahasuar ato me ngarkesën totale mikrobike në median CAPEK.

Të dhënat tregojnë se kërpudhat përbëjnë përqindje të ndryshme të ngarkesës totale mikrobike në shkolla të ndryshme, duke reflektuar dallime të dukshme në nivelin e kontaminimit mykotik ndërmjet ambienteve të studiuara. Në disa shkolla, përqindja e kërpudhave është relativisht e lartë,

çka sugjeron një prani të konsiderueshme të sporeve mykotike në ajrin e brendshëm, ndërsa në të tjera kjo përqindje paraqitet më e ulët. Ky variabilitet nxjerr në pah ndikimin e faktorëve mjedisorë si lagështia, ventilimi dhe kushtet higjieno-sanitare, të cilët ndikojnë në shpërndarjen dhe shumimin e kërpudhave. Rezultatet theksojnë rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të ngarkesës mikrobike për të garantuar cilësinë e ajrit dhe sigurinë shëndetësore në mjediset shkollore.

Figura 15. Përqindja e ngarkesës mykotike në mostrat e mbledhura nga shkollat në Vlorë (Grupi 1), krahasuar me ngarkesën totale në median CAPEK.



Të dhënat e paraqitura në Tabelën 57 për grupin e dytë të shkollave në rrethin e **Vlorës,** "Halim Xhelo", "Pilo Prifti", "Jani Minga" dhe "Ismail Qemali", ilustrojnë nivelin dhe përbërjen mikrobike në mediat PCA dhe CAPEK në ambiente të ndryshme shkollore, përfshirë klasat, korridoret dhe oborret.

Në median PCA dominojnë bakteret e pigmentuara, kryesisht bacile të verdha si dhe koloni me pigmentim të kuq dhe të verdhë, ndërsa media CAPEK tregon një prani të konsiderueshme të kërpudhave në disa ambiente, me përqindje që variojnë nga 7.7% deri në 85%.

Gjinat mykotike dominante të identifikuara përfshijnë *Aspergillus spp.*, *Mucor spp.*, *Penicillium spp.*, *Cladosporium*, *Endomycopsis* dhe *Alternaria*. Shkollat "Jani Minga" dhe "Halim Xhelo" paraqesin përqindjet më të larta të kërpudhave në mostrat e CAPEK, veçanërisht në korridore, duke sugjeruar kushte të favorshme për rritjen e kërpudhave në këto hapësira.

Ky profil mikrobik pasqyron një diversitet të lartë mikroorganizmash që mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe potencialisht në shëndetin e personave që frekuentojnë ambientet shkollore, duke theksuar nevojën për masa efektive kontrolli dhe praktika mirëmbajtjeje për të reduktuar ekspozimin ndaj ndotësve biologjikë.

Tabela 57. Rezultatet nga grupi i dytë i shkollave në qytetin e Vlorës.

Shkolla	Terreni	Koloni ne pjate	Shënime
HALIM XHELO			
Klase	PCA	15	*Bacile te verdha*
Koridor	PCA	67	Koloni baktere e maja te kuqe dhe te verdha
Oborr	PCA	49	*Bacile te verdha*
Klase	CAPEK	7 (1 fungal)	**14.3% myqe** *Mucor spp. Cladospora, Endomycopsis spp.*
Koridor	CAPEK	34 (25 fungal)	**73.5% myqe** *Aspergillus spp.*
Oborr	CAPEK	55 (11 fungal)	***20% myqe***. *Aspergillus spp*., *Aspergillus terreus, Aspergillus niger, Penicillium spp.*
PILO PRIFTI			
Klase	PCA	143	
Koridor	PCA	-	
Oborr	PCA	162	
Klase	CAPEK	69 (13 fungal)	***19% myqe*** *Penicillium spp., Aspergillus terreus, Cladospora spp., Alternaria spp.,* baktere e maja te pigmentuara,
Koridor	CAPEK	-	
Oborr	CAPEK	89 (11 fungal)	***12.5%*** myqe të të njejtës gjini *Aspergillus spp.,*
JANI MINGA			
Klase	PCA	-	
Koridor	PCA	178	Bacile te verdha
Oborr	PCA	127	Shumë baktere janë të pigmentuara në të kuq dhe te verdhe. Maja *Rhodotorula spp.* e kuqe
Klase	CAPEK	-	
Koridor	CAPEK	20 (17 myqe)	**85%** myqe, *Aspergillus spp.*
Oborr	CAPEK	91 (7 myqe)	**7.7 % myqe –***Mucor spp., Penicillium spp.*
ISMAIL QEMALI			
Klase	PCA	49	Koloni te kuqe dhe te verdha
Koridor	PCA	123	Koloni te verdha bacilesh
Oborr	PCA	167	Koloni bakteresh te kuqe dhe te verdha
Klase	CAPEK	28 (5 myqe)	**18 % myqe**
Koridor	CAPEK	36 (12 myqe)	**33 % myqe**
Oborr	CAPEK	151 (20 myqe)	**13% myqe-***Aspergillus spp.* ***Rhisopus nigricans, Mucor spp.***

Figura 16 ilustron ngarkesën totale mikrobike të zhvilluar në median PCA në grupin e dytë të shkollave në Vlorë, duke reflektuar nivelin e kontaminimit bakterial në ambiente të ndryshme si klasat, korridoret dhe oborret.

Rezultatet tregojnë një variabilitet të rëndësishëm ndërmjet shkollave dhe brenda ambienteve të ndryshme të të njëjtës shkollë, ku korridoret dhe oborret zakonisht shfaqin ngarkesa mikrobike më të larta krahasuar me klasat, siç është vërejtur në shkollat "Pilo Prifti" dhe "Jani Minga".

Të dhënat sugjerojnë se ambientet me qarkullim më të madh të njerëzve mund të përjetojnë kontaminim më të lartë mikrobik, i cili ndikohet nga faktorë si ventilimi, praktikat e pastrimit dhe dendësia e frekuentimit. Prania e kolonive me pigment të verdhë dhe të kuq tregon një diversitet të lartë mikroorganizmash, përfshirë edhe maja oportuniste.

Gjetjet theksojnë nevojën për masa të përmirësuara higjieno-sanitare në ambientet shkollore, duke u fokusuar në pastrimin dhe ventilimin e rregullt të hapësirave më të përdorura.

Figura 16. Ngarkesa totale mikrobike (numri i mikroorganizmave për pjatë Petri) në median PCA në grupin e dytë të shkollave në Vlorë.




Figura 17 paraqet ngarkesën totale mykotike të zhvilluar në median CAPEK në grupin e dytë të shkollave në Vlorë, duke reflektuar nivelin e kontaminimit nga kërpudhat në klasat, korridoret dhe oborret.


Rezultatet tregojnë dallime të rëndësishme ndërmjet shkollave dhe brenda ambienteve të ndryshme të tyre, ku korridoret e shkollave "Jani Minga" dhe "Halim Xhelo" shfaqin ngarkesat më të larta mykotike, duke sugjeruar kushte të favorshme për zhvillimin e sporeve të kërpudhave në këto

ambiente. Në disa raste, si oborret e shkollave “Pilo Prifti” dhe “Ismail Qemali”, ngarkesa mykotike është më e ulët, e cila mund të lidhet me ekspozim më të madh ndaj dritës së diellit dhe ventilim natyror.

Prania e lartë e kërpudhave si *Aspergillus spp.*, *Mucor spp.* dhe *Penicillium spp.* tregon një potencial të shtuar për kontaminim biologjik dhe rrezik për shëndetin respirator të banorëve të shkollave, veçanërisht në hapësira të mbyllura me lagështi dhe qarkullim të kufizuar të ajrit.


Këto gjetje theksojnë rëndësinë e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve mjedisore në shkolla.

Figura 17. Ngarkesa totale mykotike (numri i kërpudhave për pjatë Petri) në median CAPEK në grupin e dytë të shkollave në Vlorë.




Në grafikun e Figurës 18 dominanca mykore është në koridorin e shkollës Jani Minga -85% ndaj ngarkeses së përgjithshme ne CAPEK. Përqindja e myqeve është dominante në koridore. Po të krahasohen rezultatet e % te ngarkesave mykore, terreni PDA krahasuar me CAPEK, jep pothuaj totalisht ngarkesen mykore në pjatë, prandaj rekomandohet përdorimi i këtij terreni për të zbuluar myqet indoor/outdoor.

Figura 18. Ngarkesa mykore në % të ngarkesave totale në terren CAPEK në grupin e dytë të shkollave të Vlorë



Në figurën 19 paraqiten pamje të identifikimit të myqeve në mostrat e shkollave të Vlorës - grupi i dytë.

Figura 19. Ngarkesat mykore në CAPEK në shkollat e Vlorës - grupi i dytë.



Pamjet i përkasin një periudhe inkubimi 7 ditore. Ndërkohë numërimi u bë pas 5 ditësh, pasi zhvillimi i kolonive ishte shumë i mirë dhe ku duket qartë një bashkëjetesë e myqeve në kolonitë e pigmentuara të majave dhe baktereve.

Të dhënat nga tabela 58 për rrethin e **Malësisë së Madhe**, që përfshin katër shkolla, tregojnë ngarkesën mikrobike në ambientet e brendshme dhe të jashtme, të vlerësuara përmes medias MPA për bakteret dhe medias PDA për kërpudhat.

Në të gjitha shkollat, ngarkesa bakteriale është më e lartë në korridore dhe oborre, ndërsa klasat paraqesin vlera më të ulëta. Sa i përket ngarkesës mykotike, ajo është dukshëm e lartë dhe në disa raste dominohet në ngarkesën totale mikrobike, veçanërisht në ambientet e jashtme me praninë e bimësisë, si në shkollat "Prekë Gjoni", "Muhamet Hasmuja" dhe "Abdyl Bajraktari", ku përqindja e kërpudhave në oborr arrin deri në 100%.

Kërpudhat më të shpeshta i përkasin gjinive *Aspergillus*, *Penicillium*, *Mucor*, *Rhizopus* dhe *Cladosporium*, si dhe përfaqësues të grupeve të tjera si *Candida spp.* dhe *Trichoderma viride*.

Këto rezultate tregojnë një kontaminim biologjik të përhapur në ambientet shkollore, me ngarkesa të konsiderueshme mikrobike në ajër, veçanërisht në zonat me qarkullim më të madh të njerëzve ose pranë bimësisë natyrore. Nivelet e larta të ngarkesës mykotike në disa ambiente të brendshme paraqesin një rrezik për shëndetin e nxënësve dhe stafit, duke theksuar nevojën për përmirësimin e ventilimit dhe kushteve higjieno-sanitare në shkolla (Tabela.58).

Tabela 58. Rezultatet nga katër shkolla fillore në qytetin e Malësisë së Madhe.

Shkolla	Terreni	Koloni ne pjate	Shënime
PREKE GJONI-BAJZE			
Klase	MPA	83	
Koridor	MPA	141	
Oborr	MPA	91	
Klase	PDA	34/8 myqe	**23.5% myqe** *Mucore me shumice*
Koridor	PDA	33/30 myqe	**90.9% myqe** *Aspergillus spp.*
Oborr	PDA	65/65 myqe	***100% myqe***. Myqet jane te shtuara ne oborr pasi kishte shume bimesi: *Aspergillus terreus, Trichoderma viride, Aspergillus niger, Rhizopus nigricans, Penicillium spp.*
MUHAMET HASMUJA-GRIZH			
Klase	MPA	37	
Koridor	MPA	53	
Oborr	MPA	29	
Klase	PDA	12/12 myqe	***100% myqe*** *Penicillium crysogenum, Aspergillus rubrum, Basidiomycete-Aureobasidie, Bisoclamus fulva*

Koridor	PDA	17/17 myqe	***100% myqe*** *Maja Candida spp., Penicillium spp., Aspergillus spp, Saccharomycopsis spp. (*maja e ngjashme me myqet*)*
Oborr	PDA	26/26 myqe	***100%*** Myqet jane te shtuara ne oborr pasi ka bimesi- *Cladospora spp., Aspergillus spp., Mucor spp., Penicillium spp.*
ABDYL BAJRAKTARI-KOPLIK			
Klase	MPA	48	
Koridor	-	-	
Oborr	MPA	136	Shumë baktere janë të pigmentuara në të kuq.
Klase	PDA	15/4 myqe	**26% myqe –***Aspergillus terreus, Penicillium spp***.**
Koridor	-	-	-
Oborr	PDA	296/20 myqe	**6.8% myqe –***Mucor spp., Penicillium spp., Rhisopus nigricans.*
KOL MARTINI-DEDAJ			
Klase	MPA	83	
Koridor	MPA	99	
Oborr	MPA	67	
Klase	PDA	53/11 myqe	**20.8% myqe**
Koridor	PDA	30/15 myqe	**50% myqe**
Oborr	PDA	45/8 myqe	**17.8% myqe-***Aspergilus spp***.** *Rhisopus nigricans, Mucor spp.*

Figura 20 paraqet ngarkesat totale mikrobike të izoluara në median MPA, e cila favorizon rritjen e baktereve, nga shkollat e rajonit të Malësisë së Madhe.

Rezultatet tregojnë se korridoret dhe oborret shfaqin ngarkesa më të larta mikrobike krahasuar me klasat, duke reflektuar ndikimin e qarkullimit të njerëzve dhe kushteve mjedisore në shpërndarjen e mikroorganizmave. Shkolla "Abdyl Bajraktari" paraqet ngarkesën më të lartë në oborr, ndërsa vlera të larta në korridore vërehen në shkollat "Kol Martini" dhe "Prekë Gjoni".

Dallimet ndërmjet ambienteve sugjerojnë se faktorë të tillë si ventilimi, pastrimi, dendësia e përdoruesve dhe ekspozimi ndaj mjedisit të jashtëm ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në nivelin e kontaminimit bakterial.

Të dhënat theksojnë nevojën për ndërhyrje të rregullta higjieno-sanitare dhe përmirësime të cilësisë së ajrit në zonat më të frekuentuara të shkollave.

Figura 20. Paraqitje grafike e ngarkesave totale mikrobike në shkollat e Malësisë së Madhe (media MPA).





Figura 21 paraqet përqindjen e ngarkesës mykotike të izoluar në median PDA në shkollat e Malësisë së Madhe, krahasuar me ngarkesën totale mikrobike në të njëjtën media. Sikurse shihet edhe nga ky grafik në të gjitha shkollat, në koridor del ngarkese me e madhe krahasuar me klasat dhe oborrin. Ngarkesat në oborr janë të lidhura me bimësine dhe prandaj në shkollat me bimësi dominojnë myqet, por ka qarkullim ajri, mjedise shumë të pastra dhe ngarkesa në oborr del e vogël. Klasat ajrisen më shpesh, ndërkohë që koridoret që qarkullohen shumë, kanë lidhje me transmetimin indoor/outdoor të ngarkesave dhe ofrojne ngarkesë më të madhe. Koridoret e gjata dhe jo ato me holle, kanë më pak dritare, të cilat ndodhen në klasa. Pavarësisht nga kujdesi higjeno-sanitar prania e myqeve në to është më e lartë se mjediset e tjera, por gjithmone brenda normës.

Rezultatet tregojnë një variabilitet të konsiderueshëm ndërmjet shkollave dhe ambienteve të ndryshme, ku në disa raste kërpudhat përbëjnë deri në 100% të ngarkesës totale, veçanërisht në oborre ose zona me praninë e madhe të bimësisë. Përqindje më të ulëta të kërpudhave vërehen në klasat dhe ambientet e brendshme me ventilim më të mirë ose lagështi më të ulët.


Mbizotërimi i ngarkesës mykotike në disa shkolla sugjeron kushte të favorshme për rritjen e këtyre mikroorganizmave dhe mund të paraqesë rrezik për shëndetin respirator të nxënësve dhe stafit. Figura thekson nevojën për monitorim të vazhdueshëm të kontaminimit mykotik dhe ndërhyrje për përmirësimin e kushteve mjedisore, veçanërisht në hapësirat më të prekur nga prania e kërpudhave.

Figura 21. Paraqitja e përqindjes së ngarkesës mykotike krahasuar me ngarkesën totale në median PDA në shkollat e Malësisë së Madhe.



Në imazhet e figurave më poshtë paraqiten ngarkesat mykore në disa zona mostrimi të Malësisë së Madhe.

Figura 22. Myqe në oborr të shkollës Prekë Gjoni-Bajzë (prani e *Trichoderma viride*)



Shkolla Prek Gjoni e Bajzës ka nje bimësi të spikatur dhe prania e saj sipas literaturës është edhe burim i izolimit aty të *Trichoderma viride*. Ky myk i perket familjes *Hypocreaceae* dhe gjendet në tokë, bimë, drurë me lagështi, bimësi të kalbur, etj. Vetë *Trichoderma viride* nuk krijon problem në shëndet, ka një zhvillim simbiotik me disa myqe por edhe ushtron një biokontroll të spikatur në zhvillimin e myqeve pathogjenë por edhe baktereve pathogjene . Prania e tij "pastron terrenin" për zhvillimin e pathogjenëve të tjerë dhe kjo duket qartë edhe në figurën më sipër. Në studimin e saj morfologjik ofrohet pamja si më poshtë:

Foto 10. Pamje në mikroskop të konidieve të *Trichoderma viride*
(Gerald Holmes, Strawberry Center, Cal Poly San Luis Obispo, Bugwood.org)



Figura 23. Myqe në klasë, në shkollën Abdyl Bajraktari Koplik. *(Aspergillus terreus, Penicillium spp*.)





Figura 24. Myqe në oborr tek shkolla Muhamet Hasmuja – Grizh




Në Figurën 24 dominojnë speciet e gjinisë *Cladosporium.* Krahasuar me doktor Fungus, Foto 11, jane koloni identike në morfologji - konidie dhe në anën e mbrapme të kolonive në PDA -koloni të zeza në hiri, të ngjeshura me zhvillim jo shumë të madh pas 7 ditësh, dhe me konture të qarta. Gjinia *Cladosporium* është myku i shtëpive, mureve, banjave dhe natyrshëm del në ajër sidomos në zonat e hyrjes së ndërtesave. Kjo gjini rritet në mjedise outdoor dhe indoor me shumicë dhe ka një veti të spikatur që sporet përhapen në ajër, prandaj gjendet në ajrin outdoor dhe indoor. Nuk konsiderohet myk toksik, por mikroflorë e zakonshme e mjedisit. Sipas portalit Healthline, ne raste të rralla mund të shkaktojë alergji, kollë, apo infeksione. Në figurën më poshtë paraqitet zhvillimi në Pjatë Petri dhe pamja në mikroskop optik për të krahasuar të parën me pamjen tonë eksperimentale (në të dy rastet duken qartë rrathët e zinj identifikues të kolonisë në PDA)

Foto 11, 12. *Cladosporium spp.*- zhvillimi në Pjatë Petri dhe pamja në mikroskop optik sipas *ALAMY dhe Alchetron.com*




Figura 25. Myqe në klasë tek shkolla Muhamet Hasmuja - Grizh.
Bysoclamus fulva (myku i bardhë), Penicilium chrysogenum, Aspergillus rubrum, Bazidiomycetes (Aureobasidium)



Penicillium chrysogenum është myk tipik i mjediseve indoor, prandaj është identifikuar si një myk i gjendur në klasë në shkollën Muhamet Hasmuja. Është identifikuar si myk indoor i zonave ku lagështia ka bërë punën e saj, në ndërtesa të ndërtuara prej kohësh, pasi favorizohet edhe nga temperaturat e larta, por edhe nga aktiviteti i lartë i ujit. (Shkollat e Malësisë së madhe kanë sidoqoftë edhe influencën e Liqenit të Shkodrës.) Më parë ky myk është njohur me emrin *Penicillium notatum* dhe ka qënë objekt studimesh si prodhues i antibiotikëve që përmbajnë unazën e β laktamit dhe që përdoren për të shkatërruar metabolizmin e disa baktereve të dëmshme (Figura 26).

Figura 26. Antibiotikët me unazën e β laktamit dhe emërtimet e tyre



Në shkollën e Grizh-it, në klasë është identifikuar edhe myku i ngashëm me majatë – *Aureobazidium pullulans* që shpesh herë identifikohet si maja e grupit të *Bazidiomyceteve.* Gjetja në klasë mund të lidhet edhe me konsumin e produkteve sheqerore apo pijeve të ëmbla në kohën e pushimit, në klasë. Nga pikpamja e pranisë indoor/ outdoor, kryesisht është indoor, por ka mjedise ku ka edhe përhapje outdoor. Në foton 13 më poshtë paraqitet zhvillimi në pjatë Petri për t'u krahasuar me gjininë e izoluar në klasë në figurën më sipër.

Foto 13. Zhvillimi i kolonive të *Aureobazidium pullulans* marrë nga *NARO Genebank.*





Foto 14. Makro dhe mikromorfologjia e *Aureobasidium pullulans* marrë nga *Researchgate*



Sikurse shihet nga pamja e arkivuar, ngjashmëria me koloninë tonë të izoluar është shumë e madhe.

Edhe vrojtimi mikroskopik dha të njejtën pamje të përhapjes së bazidieve.

Më poshtë jepen foto nga eksperimentimi në shkollat e Malësisë së Madhe.

Foto 15. Shkolla e Bajzës në Malësi të madhe. Vëndi ku u bë mostrimi në oborr.



Foto 16, 17. Shkollat Abdyl Bajraktari –Koplik dhe Muhamet Hasmuja-Grizhë Vëndet ku u bë mostrimi në oborr.



Rezultatet e monitorimit nga katër shkolla në **Kukës,** "1 Qershori", "Riza Spahiu", "Lidhja e Prizrenit" dhe "Bajram Curri", tregojnë ngarkesa të ndryshme mikrobike në ambientet e brendshme dhe të jashtme, të vlerësuara përmes mediave PCA dhe CAPEK.


Në përgjithësi, ngarkesa bakteriale e matur në median PCA është më e lartë në korridore dhe oborre, veçanërisht në shkollën "Riza Spahiu", ku u vërejtën koloni të shumta të pigmentuara të baktereve Gram-pozitive dhe Gram-negative. Sa i përket ngarkesës mykotike në median CAPEK, vetëm shkolla "1 Qershori" tregon prani të kërpudhave në të gjitha ambientet, me mbizotërim të *Aspergillus spp.*, ndërsa shkolla "Riza Spahiu" paraqet përqindje të kufizuara të kërpudhave në klasat dhe oborret, duke përfshirë gjinitë si *Penicillium*, *Cladospora* dhe *Alternaria spp.*. Përkundrazi, ngarkesa mykotike në shkollat "Lidhja e Prizrenit" dhe "Bajram Curri" është pothuajse e papërfillshme, duke sugjeruar kushte më pak të favorshme për zhvillimin e kërpudhave ose faktorë mbrojtës të tjerë, si ventilimi adekuat dhe lagështia e ulët. Të dhënat tregojnë se kontaminimi mikrobik në shkollat e Kukësit është kryesisht bakterial dhe jo mykotik; megjithatë, prania sporadike e *Aspergillus spp.* dhe specieve të tjera oportuniste në disa ambiente nënvizon nevojën për monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit dhe higjienës në institucionet arsimore (tabela.59).

Tabela 59. Rezultatet e monitorimit të ngarkesës totale mikrobike dhe mykotike në katër shkolla të Kukësit.

Shkolla	Terreni	Koloni në pjatë	Shënime
NJË QERSHORI			
Klase	PCA	23	Koloni te pigmentuara
Koridor	PCA	34	Koloni te pigmentuara
Oborr	PCA	-	
Klase	CAPEK	3/3 myqe	**100% myqe** *Aspergillus spp.*
Koridor	CAPEK	108/4 myqe	**3.7% myqe** *Aspergillus spp.*
Oborr	CAPEK	32/6 myqe	18.75% myqe, *Aspergillus spp. Aureobazidium spp.*
RIZA SPAHIU			
Klase	PCA	58	koloni bakteresh te verdha dhe te kuqe
Koridor	PCA	182	koloni bakteresh te verdha
Oborr	PCA	89	koloni bakteresh te verdha dhe te kuqe
Klase	CAPEK	56/ 3 myqe	***5.4% myqe*** *Penicillium spp., Cladospora spp.*
Koridor	CAPEK	13/0 myqe	***0% myqe***
Oborr	CAPEK	54/9 myqe	***16.6%*** *Alternaria spp., Aspergillus spp., Mucor spp.*
LIDHJA E PRIZRENIT			
Klase	PCA	20	koloni bakteresh-bacile gr.+
Koridor	PCA	35	koloni bakteresh-bacile gr.+
Oborr	PCA	80	koloni bakteresh-bacile gr.+
Klase	CAPEK	36/0 myqe	**0 % myqe**
Koridor	CAPEK	35/0 myqe	**0 % myqe**
Oborr	CAPEK	83/0 myqe	**0 % myqe**
BAJRAM CURRI			
Klase	PCA	24	
Koridor	PCA	18	
Oborr	PCA	-	
Klase	CAPEK	36/ 0 myqe	**0 % myqe**
Koridor	CAPEK	43/0myqe	**0 % myqe**
Oborr	CAPEK	45/1myqe	**2.2% myqe-***Aspergillus spp.*

Në figurën 27 paraqiten ngarkesat mykore në terren CAPEK. Sikurse shihet edhe nga pjatat në terren CAPEK, duket qartë mungesa e myqeve në mjediset indoor/outdoor në shkollat e Kukësit. Mesa duket thatësira dhe klima kanë qenë jofavorizuese për zhvillimin e tyre. Vetëm oborri i shkollës 1 Qershori ka një ngarkesë mykore të gjinive *Aspergillus* dhe *Aureobazidium*. Mbetet të vërtetohet që në mjediset indoor/outdoor në shkollat e zonave të veriut ngarkesa mykore është shumë më e vogël se në zonat e Shqipërisë së mesme dhe ato të jugut.

Figura 27. Ngarkesat e mikroorganizmave në terren CAPEK në shkollat e Kukësit



Për të patur një mundësi të mirë të studimit morfologjik të kolonive të myqeve të zhvilluara në terrenin Capek, numërimi i tyre u bë në 5 dhe 7 ditë inkubim. Më pas u la të zhvilloheshin edhe 1 deri në 2 ditë të tjera. Imazhet e makrokolonive të zmadhuara paraqiten në Figurën 28.

Figura 28. Myqet e izoluara në proçes studimi morfologjik




Figura 29 paraqet ngarkesat totale mikrobike (TVC) të izoluara në median PCA në shkollat e Kukësit dhe tregon se korridoret janë ambientet me ngarkesën më të lartë bakteriale në të gjitha shkollat, veçanërisht në shkollën "Riza Spahiu", ku ngarkesa arrin nivele të larta, e ndjekur nga oborret dhe më pas klasat.

Kjo shpërndarje sugjeron se ambientet me qarkullim më të madh dhe ekspozim ndaj faktorëve të jashtëm kontribuojnë në rritjen e kontaminimit mikrobik. Oborret, ku u morën gjithashtu mostrat, paraqesin ngarkesa të konsiderueshme, ndoshta të lidhura me kontaktin me mjedisin natyror, ndërsa klasat shfaqin ngarkesat më të ulëta, duke reflektuar kushte më të kontrolluara.

Ky model thekson rëndësinë e higjienës dhe ventilimit të rregullt në zonat me qarkullim të lartë për të reduktuar ekspozimin ndaj ngarkesave mikrobike në institucionet arsimore.

Figura 29. Ngarkesa totale mikrobike (TVC) në median PCA në shkollat e Kukësit.




Figura 30 paraqet një krahasim midis ngarkesave totale mikrobike dhe ngarkesave specifike mykotike të izoluara në median CAPEK në shkollat e Kukësit.

Ngarkesat totale zakonisht janë më të larta se ngarkesat mykotike në shumicën e shkollave, duke treguar se bakteret dhe mikroorganizmat e tjerë jo-mykozë janë më të përhapur në ambientet e testuara. Megjithatë, në disa ambiente, si klasat e shkollës "Një Qershori", ngarkesa mykotike përbën 100% të ngarkesës totale, duke sugjeruar kushte jashtëzakonisht të favorshme për rritjen e kërpudhave.

Përkundrazi, disa shkolla si “Lidhja e Prizrenit” dhe “Bajram Curri” nuk tregojnë ngarkesë të dallueshme mykotike, pavarësisht ngarkesave totale të konsiderueshme, duke sugjeruar kushte më pak të favorshme për shumimin e këtyre mikroorganizmave.

Të dhënat theksojnë variabilitetin e përbërjes mikrobike në ambiente të ndryshme shkollore dhe nevojën për vlerësime specifike të pranishmërisë së kërpudhave për shkak të ndikimit të tyre potencial në shëndetin respirator.

Figura 30. Ngarkesa totale dhe mykotike në median CAPEK (ngjyra e kuqe – ngarkesat totale, ngjyra blu – ngarkesat mykotike).





Figura 31 ilustron përqindjen e ngarkesës mykotike në raport me ngarkesën totale mikrobike në median CAPEK në shkollat e Kukësit, duke nxjerrë në pah dallime të rëndësishme ndërmjet shkollave dhe ambienteve të ndryshme.

Përqindja më e lartë e kërpudhave është regjistruar në klasat e shkollës “Një Qershori” me 100%, ndërsa korridori dhe oborri i saj tregojnë përqindje prej 3.7% dhe 18.75%, përkatësisht, duke reflektuar kushtet e ndryshme mjedisore brenda së njëjtës shkollë.

Në shkollën “Riza Spahiu” vërehen përqindje të ulëta në klasë dhe korridor, por vlera më të larta në oborr, ndoshta të lidhura me ekspozimin ndaj bimësisë. Shkollat “Lidhja e Prizrenit” dhe “Bajram Curri” shfaqin përqindje mykotike shumë të ulëta ose të papërfillshme, duke sugjeruar kushte më pak të favorshme për rritjen e kërpudhave, si ventilim më i mirë ose lagështi më e ulët.

Kjo figurë thekson se prania e kërpudhave nuk është e shpërndarë në mënyrë uniforme dhe lidhet ngushtë me faktorët mjedisorë dhe higjienikë lokalë.

Figura 31. Myqet në perqindje të ngarkesave totale në CAPEK në shkollat e Kukësit



Në rrethin e **Fierit** puna eksperimentale u përqëndrua në 6 shkolla: "Zylyftar Veleshnja", "Jorgo Sapiku", "Rexhep Kother", "Levizja Demokratike", "Lili Stavri", "Kristaq Shtembari". Mundësia e testimit në këto shkolla ishte në oborret dhe korridoret e tyre. Në pothuajse të gjitha rastet konfirmohet prania e ngarkesave më të mëdha në koridore për shkak të një qarkullimi të limituar të ajrit dhe pranisë më të madhe të nxënësve. Në dallim nga shkollat e tjera ka patur një dominancë të dukshme të të njejtave baktere bacilli Gr+ të verdha që mund të konsiderohen jo florë ndotëse por epifite e zonës. Edhe këtu ka dominancë të të njejtave ngarkesa mykore me dominim gjininë Aspergillus. Prania e Mucoreve ka qenë shumë më e pakët se në shkollat e tjera dhe ka shumë mundësi që periudha shumë e thatë e vitit kur u morën mostrat të ketë ndikuar në reduktimin e dukshëm të ngarkesave mykore.

Tabela 60 paraqet rezultatet e monitorimit të ngarkesave totale mikrobike dhe ngarkesave specifike mykotike në gjashtë shkollat e Fierit, duke analizuar mostrat e marra nga korridoret dhe oborret në mediat PCA dhe CAPEK.

Shkolla "Zylyftar Veleshnja" tregon një ngarkesë të lartë mykotike në korridor, ku 100% e kolonive përbëhen nga *Aspergillus spp.*, *Cladosporium spp.* dhe *Penicillium spp.*, ndërsa përqindja mykotike në oborr është shumë e ulët, me vetëm një koloni të zbuluar. Në shkollën "Jorgo Sapiku",

përqindja e kërpudhave arrin 100%, por vetëm në një koloni të korridorit, ndërsa në oborr nuk janë vërejtur kërpudha.

Shkolla "Rexhep Kother" paraqet ngarkesa mykotike të moderuara në korridor dhe oborr, me përqindje rreth 25–27% dhe speciet tipike mykotike të përfaqësuara. "Levizja Demokratike" shfaq një ngarkesë shumë të lartë bakteriale në oborr, por përqindje shumë të ulëta mykotike në korridor dhe oborr, duke sugjeruar mbizotërimin bakterial në mikrobiotën e ambientit.

Shkollat "Lili Stavri" dhe "Kristaq Shtembari" tregojnë raste të baktereve me pigment të lartë dhe, në disa raste, makrokoloni të *Bacillus spp.* që mbulojnë të gjithë pjatën. Përqindjet e kërpudhave variojnë nga 2.5% deri në 30%, duke treguar një variabilitet të konsiderueshëm të ngarkesës mykotike në varësi të vendndodhjes dhe kushteve mjedisore.

Të dhënat tregojnë se kontaminimi mikrobik është më i shprehur në korridore për shkak të qarkullimit më të limituar dhe pranisë së lartë të nxënësve, ndërsa shpërndarja e kërpudhave ndryshon dhe ndikohet nga faktorë si lagështia, ventilimi dhe prania e bimësisë.

Tabela 60. Rezultatet e monitorimit të ngarkesave totale mikrobike dhe mykotike në gjashtë shkolla të rrethit të Fierit.

Shkolla	Terreni	Koloni në pjatë	Shënime
Zylyftar Veleshnja - Velmisht			
Koridor	PCA	47	Koloni te pigmentuara, te verdha
Oborr	PCA	36	
Koridor	CAPEK	12/12 myqe	**100% myqe** *Aspergillus spp., Clasospora spp.Penicillium spp.*
Oborr	CAPEK	26/1 myk	**3.85%** myqe, *Aspergillus spp.*
Jorgo Sapiku - Luar			
Koridor	PCA	30	koloni bakteresh te verdha
Oborr	PCA	30	koloni bakteresh te verdha
Koridor	CAPEK	1/1 myqe	**100% myqe-** 1 koloni *Alternaria spp*
Oborr	CAPEK	2/0 myqe	**0%** myqe
Rexhep Kother - Kuman			
Koridor	PCA	11	koloni bakteresh-bacile gr.+ te verdha
Oborr	PCA	21	koloni bakteresh-bacile gr.+te verdha
Koridor	CAPEK	15/4 myqe	**26.7 % myqe**
Oborr	CAPEK	12/3 myqe	**25 % myqe**
Levizja Demokratike - Fier			
Koridor	PCA	33	koloni baktere te pigmentuara-bacile gr+ te verdha
Oborr	PCA	124	koloni te bardha dhe te pigmentuara-baktere

Koridor	CAPEK	31/2 myqe	**6.45 % myqe**
Oborr	CAPEK	73/1myqe	**1.37% myqe-***Aspergillus spp.*
Lili Stavri - Topoje			
Koridor	PCA	145	koloni baktere te pigmentuara-bacile gr+ te verdha
Oborr	PCA	1	makrokoloni bakteri *Bacillus spp* qe mbush pjaten.
Koridor	CAPEK	49/5 myqe	**10.2 % myqe**
Oborr	CAPEK	121/3 myqe	**2.47 % myqe**
Kristaq Shtembari - Fier			
Koridor	PCA	86	koloni baktere te pigmentuara-bacile gr+ te verdha
Oborr	PCA	1	makrokoloni bakteri *Bacillus spp* qe mbush pjaten.
Koridor	CAPEK	15/2 myqe	**13.33 % myqe**
Oborr	CAPEK	10/3 myqe	**30% myqe-***Aspergillus spp.***,** *Mucor spp.*

Figura 32 ilustron ngarkesat totale mikrobike në median PCA në shkollat e Fierit, duke reflektuar dendësinë mesatare të kolonive bakteriale dhe mikrobike në mostrat e ndryshme të marra nga këto shkolla. Rezultatet tregojnë një variacion të konsiderueshëm ndërmjet shkollave dhe ambienteve të ndryshme brenda tyre, ku disa shkolla shfaqin ngarkesa më të larta mikrobike, ndërsa të tjera paraqesin nivele më të ulëta. Duket qartë një ngarkesë shumë e vogël mykore në shkollat Lili Stavri dhe Kristaq Shtembari. Në 4 prej 6 shkollave ngarkesa në koridor është më e madhe se në oborr, ndërkohë edhe numri i ngarkesave në oborr vjen nga e njëjta specie *Bacillus spp.* Gr+ (me shumë mundësi *Serratia marcescens* nga të dhënat morfologjike). Ky variacion sugjeron ndikimin e faktorëve mjedisorë dhe menaxhimit të higjienës në nivelin e kontaminimit mikrobik. Për më tepër, disa shkolla duket se kanë një prani më intensive të baktereve të pigmentuara, gjë që mund të tregojë kushte të veçanta që favorizojnë rritjen e mikroorganizmave të caktuar. Përqendrimet më të larta në disa zona mund të lidhen me faktorë të tillë si lagështia, ventilimi i pamjaftueshëm dhe prania e materialeve organike.

Figura 32. Ngarkesat totale mikrobike në median PCA në shkollat e Fierit.





Figura 33 paraqet ngarkesat mykotike në median CAPEK në shkollat e Fierit, duke treguar përqindjen dhe dendësinë e kolonive mykotike në mostrat e ndryshme. Duket qartë një ngarkesë myqesh shumë e kufizuar me dominancë shumë pak gjini *Aspergillus spp., Cladospora spp*., shumë pak myqe të gjinisë *Mucor spp*.. Duke qenë se kjo është një gjini që ka gjetur përhapje shumë të madhe neëterrene specifike, Saboraud, PDA dhe CAPEK, konsiderohet pozitive mungesa e saj në pjesën më të madhe të shkollave dhe sidomos mungesa në koridore.

Në shkollën Zylyftar Veleshnja ngarkesa mykore është më e madhe por edhe kjo e rendit të parë - 10^1, pra brenda normave të lejuara me ligj. Vlen të theksohet që edhe në shkollat e Fierit ngarkesa totale dhe mykore është brenda normave, rendi 10^1 dhe 10^2 dhe me një risk minimal kontaminimi për nxënësit. Në asnje rast nuk është vrojtuar prania e pathogjeneve si *Aspergillus fumigatus*, *Aspergillus flavus* apo *Candida mycoderma* dhe *Candida spp*. në tërësi.

Kërpudhat më shpesh të identifikuara përfshijnë *Aspergillus spp.*, *Penicillium spp.* dhe *Cladosporium spp.*, të njohura për rolin e tyre në kontaminimin e ambientit të brendshëm dhe ndikimin potencial në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e njeriut.

Figura 33. Ngarkesat mykotike në median CAPEK në shkollat e Fierit.



Për shkollat e rrethit të **Tiranës** rezulatatet janë të ndryshme dhe variojnë në varësi të ambienteve ku është bërë mostrimi. Duhet të themi se jo në të gjitha shkollat e Tiranës është berë mostrimi indoor për shkak të vështirësisë në marrjen e lejes për të hyrë në ambjentet e brendshme të shkollave. Megjithatë në bazë të të dhënave të marra dhe përllogaritjeve kemi mundur të bëjmë disa parashikime dhe vlerësime mbi nivelin e ndotjes në shkollat e Tiranës.

Në shkollën "**Kosova**" vihet re prezencë e *Alternaria* dhe *Fusarium* janë të njohur si alergjenë të fuqishëm të ajrit; prania e tyre e zgjatur brenda klasës mund të shoqërohet me simptoma të asmës ose simptomat alergjike te nxënësit dhe stafi. Specie të gjinisë Fusarium përmenden për sintezë të mykotoksinave të klasës së fumonisinave trikotecenave dhe zerealenone. *Fungi imperfecti* shpesh rritet në sipërfaqe me lagështi të lartë (p.sh., mure me ngjitje, tavan), duke treguar nevojën për kontroll të lagështisë (dezinfektim, tharje, ventilim).

Tabela 61 përmbledh mikroorganizmat e identifikuar në shkollën Kosova si dhe interpretimin e rezultateve në lidhje me cfarë sinjalizon prezenca e tyre. Nga kjo tabelë vihet re se ngarkesa mikrobiale nga jashtë hyn lehtësisht brenda ndërtesës, dhe ka vend për përmirësim të ventilimit dhe kontrollit të lagështisë për të ruajtur një ambient më të shëndetshëm për nxënësit dhe mësuesit.

Tabela 61. Përhapja e mikroorganizmave në zonat e ndryshme të shkollës Kosova

Zona	Mikroorganizmat e identifikuara	Interpretimi i rezultatit
Oborri (jashtë)	• Fungi imperfecti • Alternaria • Oidium • Fusarium	**Larmi e lartë saprofitësh dhe patogjenësh të mundshëm:** Tregon prezencë të sporeve që rrjedhin nga bimët përreth (Oidium) dhe nga materialet organike në tokë. Alternaria e Fusarium mund të jenë burim alergjenesh dhe mykotoksinash.
Korridoret (ndërmjetëse)	• Oidium • Alternaria	**Filtrim i pjesshëm i sporeve:** Janë gjetur vetëm sporet më të lehta të transportueshme në rrugë ajrore (Oidium) dhe Alternaria. Mjedisi ka ventilim të pamjaftueshëm dhe kalim të hapur të ajrit nga jashtë, brenda.
Klasa (brenda)	• Alternaria • Fungi imperfecti • Fusarium	**Transferimi i sporeve në ambient të mbyllur:** Identifikimi I Alternaria dhe Fusarium brenda tregon se sporet jashtë hyjnë përmes dritareve, derës apo ventilimit. Fungi imperfecti mund të jenë gjithashtu të pranishëm në mure ose mobilje me lagështi.

Tabela 62 paraqet rezultatet e monitorimit të ngarkesave totale mikrobike dhe ngarkesave specifike mykotike në shkollën Kosova, duke analizuar mostrat e marra nga korridoret dhe oborret dhe klasat në mediat PCA dhe CAPEK. Korridoret kanë ngarkesën më të lartë bakteriale, oborri ka ngarkesën më të lartë fungale, dhe klasat, megjithëse më të ulëta në numër absolut, vazhdojnë të kenë një raport spore/baktere që mund të ndikojë në shëndetin e nxënësve. Zbatimi i filtrimit, ventilimit, kontrollit të lagështisë dhe një plani të rregullt pastrimi/dezinfektimi do të reduktojë ndjeshëm këto ngarkesa.


Tabela 62. Ngarkesa mikrobiale në terrenet PCA dhe Capek (SHKOLLA KOSOVA)

Vendi i marjes se mostres	Nr.kolonive (PCA-baktere totale aerobe)	CFU /m^3	Nr.kolonive ne pjaten e Petrit me Capek	CFU/m^3	Totali myqe si % e ngarkesës baktereve
OBORR	92	4056	13	573	14.1 %
KORRIDOR	118	5202	4	176	3.4 %
KLASE	45	1984	2	88	%

Figura 34 paraqet ngarkesat bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të shkollës Kosova, duke treguar dendësinë e kolonive mykotike në mostrat e ndryshme. Nga analiza e ngarkesës bakteriale: klasa paraqet vlerat me të ulta, ndërsa Korridori ka presence më të lartë bakteresh se klasa dhe oborri rreth 2.0 herë më shumë se klasa. Nga analiza e ngarkesës mykore, vihet re se vlerat më të larta i kanë korridoret me oborrin dhe vlerat më të ulta klasa. Për sa I përket raporti myqe:baktere: Oborri tregon prani të konsiderueshme sporesh, Korridori tregon dominim

bakterial, me spore të kufizuara që transmetohen nga jashtë ndërsa Klasa edhe pse nivelet absolute të sporeve janë më të ulëta, raporti tregon se një pjesë e konsiderueshme e ngarkesës ajrore brenda konsiston në myqe.

Figura 34. Krahasimi i ngarkesës bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të Shkolles Kosova.



Figurat 35 dhe 36 paraqesin ngarkesat totale mikrobike të izoluara në median PCA dhe CAPEK në shkollën Kosova. Numri i lartë i ngarkesës bakteriale (më e larta në korridor) vjen si rezultat i faktit se zona e korridoreve është "rruga kryesore" e qarkullimit të ajrit, prandaj mbledh më shumë baktere nga ambienti i jashtëm dhe mund të favorizojë shpërndarjen e patogjenëve ndërmjet klasave. Nga ana tjeër, numri i lartë i myqeve në oborr, vecanërisht prezenca e lartë e myqeve ambientale (p.sh. *Cladosporium, Alternaria)* tregon bimësi të dendur dhe material organik në oborr. Prania e sporeve brenda klasave edhe pse është më e ulët paraqet rrezik. Cdo prani sporesh brenda mund të përkeqësojë simptomat alergjike te nxënësit astmatik ose me rrugë të ndjeshme të frymëmarrjes.

Të dhënat reflektojnë nevojat për: Përmirësim ventilimi - Vendosja e filtrave të ajrit me mikropore dhe ajrosje e rregullt (sidomos në mëngjes). Kontroll i lagështisë - Përdorimi i dehumidifikatorëve ose riparimi i rrjedhjeve për të mbajtur lagështinë relative nën 60%. Pastrim dhe dezinfektim - Zona të ekspozuara ndaj lagështisë duhen pastruar periodikisht me solucione antimykotikë. Monitorim i rregullt - Marrja e mostrave dhe analizimi i tyre për të ndjekur ndryshimet e ngarkesës mikrobiale ne kohë dhe sezone të ndryshme.

Figura 35: Pamje e garkeses mikrobiale ne terren PCA. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase *Shkolla Kosova*:





Figura 36: Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren Capek. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase *Shkolla Kosova*:



Në shkollën "7 Marsi", në ambientin e jashtëm evidentohen myqet "Fungi imperfecti" (p.sh. Aspergillus spp., Penicillium spp.) dhe Alternaria, të cilat janë normale në mjedis, por nivelet e larta tregojnë depozitim ne perqëndrim të lartë në tokë, bimësi dhe materiale organike. (Tabela 63). Në ambjentet e brendshme prania e makrokonideve dhe Cladosporium-it brenda klasave tregon që filtrimi i ajrit nuk është i mjaftueshëm, sporet transportohen përmes ventilimit, dritareve të hapura dhe rrugëve të tjera të ajrit. *Cladosporium* dhe *Alternaria* mund të shkaktojnë simptoma alergjie (sytë lotues, kollë, teshtima) dhe të rëndojnë çrregullimet e astmës te nxënësit ose stafi. Myqet "Fungi imperfecti" në korridore mund të formojnë koloni në pika me lagështi të fshehtë.

Tabela 63. Përmbledhje e përhapjes së mikroorganizmave në zonat e ndryshme të shkollës dhe çfarë sinjalizojnë ato.(Shkolla 7 Marsi)

Zona	**Mikroorganizmat e identifikuar**	**Interpretim kryesor**
Oborri (jashtë)	Fungi imperfecti	Prezencë e myqeve të përgjithshme ambientale, të cilat çlirojnë spore nga toka dhe materia organike.
Korridoret	Fungi imperfecti Makrokonide Alternaria	Transferim spore nga jashtë në ambiente të mbyllura; makrokonidet (p.sh. Aspergillus, Penicillium) dhe Alternaria janë alergjenë të njohur të ajrit.

Klasat (brenda)	Makrokonide të degezuara Cladosporium	Cladosporium prodhon makrokonide të degezuara dhe është një nga alergenët më të fuqishëm të brendshëm; sinjalizon ventilim të pamjaftueshëm dhe lagështi të lartë.


Tabela 64 paraqet rezultatet e monitorimit të ngarkesave totale mikrobike dhe ngarkesave specifike mykotike në shkollën 7 Marsi, duke analizuar mostrat e marra nga korridoret dhe oborret dhe klasat në mediat PCA dhe CAPEK. Vihet re se ngarkesa bakteriale në shkollën 7 Marsi është më e lartë në oborr më e ulët në klasa. Korridori ka më pak baktere se oborri dhe klasa ka vetëm ~4 % më pak se korridori, që tregon mbartje të vazhdueshme të baktereve nëpërmjet ajrit dhe këpucëve. Për sa i përket ngarkesës mykore ajo më e lartë është në oborr, e më e ulëta në klasa. Vihet re se korridori ka më pak myqe se oborri kurse klasa ka 50 % më pak myqe se korridori, që tregon efektin e pastrimit/ventilimimit të ambienteve të brendshme. Raporti myqe:baktere në oborr tregon një mbizotërim relativ të baktereve, por prani të moderuar të sporeve ambientale. Në korridor ka një raport i ngjashëm me oborrin, duke sinjalizuar se korridoret "trashëgojnë" përbërjen mikrobiologjike të jashtme. Në klasa ka ulje të ndjeshme e përqindjes së sporeve, që reflekton pastrim dhe mirëmbajtje më të mirë të brendshme. Po prezenca e vazhdueshme e baktereve deri në klasë mund të krijojë terren për transmetim patogjenësh. Brendësia e klasave, (me raport nën 3 %,) tregon që masat higjieno-ventiluese po funksionojnë pjesërisht, por ka vend për përmirësime.

Tabela 64. Ngarkesa mikrobiale dhe mykotike ne pjatat e Petrit. Shkolla 7 Marsi

Vendi i marjes se mostres	**Nr.kolonive (PCA-baktere totale aerobe)**	**CFU /m 3**	**Nr.kolonive ne pjaten e Petrit me Capek**	**CFU/m 3**	**Raporti Fungi:ngarkesë mikrobiale(%)**
OBORR	88	3880	5	220	5.67 %
KORRIDOR	72	3174	4	176	5.55 %
KLASE	69	3042	2	88	2.89 %

Figura 37 tregon se oborri është burimi kryesor i baktereve dhe myqeve. Korridoret e transferojnë këtë ngarkesë brenda ndërtesës, ndërsa klasat, megjithëse më "të pastruara", ende përmbajnë baktere në nivele të konsiderueshme. Zbatimi i ventilimit, filtrimit dhe pastrimit të rregullt do të ulë në mënyrë të ndjeshme ngarkesën mikrobiologjike dhe do të përmirësojë cilësinë e ajrit në shkollë.

Figura 37. Krahasimi i ngarkesës bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të Shkolles 7 Marsi.



Rezultatet rekomandojnë ventilim dhe filtrim të ajrit nëse është e mundur ose thjesht ajrosje e përditshme (5–10 min) para fillimit të mësimit dhe pasdite. Pastrim i thellë i dyshemeve dhe sipërfaqeve horizontale (të paktën 1–2 herë/javë). Dezinfektim antimykotik si dhe mbajtja e lagështisë relative nën 60 % sidomos në korridore.

Figurat 38 dhe 39 paraqesin pamjet e ngarkesave mikrobike në terren PCA dhe CAPEK.

Figura 38. Pamje e ngarkesës mikrobiale në terren PCA. Nga e majta në të djathtë Oborr, Korridor dhe Klasë, Shkolla 7 Marsi





Figura 39. Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren Capek. Nga e majta në të djathtë Oborr, Korridor dhe Klasë, Shkolla 7 Marsi.



Në tabelën 65 është bërë një përmbledhje të përhapjes së mikroorganizmave në zonat e ndryshme të **Shkollës së Baletit** dhe çfarë sinjalizojnë ato. Nga tabela evidentohet prezenca e *Fusarium* e cila mund të prodhojë mykotoksina irrituese për traktin respirator. *Cladosporium* dhe *Fungi imperfecti* janë alergjenë të zakonshëm, të cilët mund të shkaktojnë teshtima, kollë, dhe shqetësim për persona me astmë. Rritja e micelit të Oidium brenda klasave mund të çojë në acarim të mukozës dhe simptoma mykotike në lëkurë.

Vihet re se ekziston fluks i vazhdueshëm i sporeve nga jashtë në klasa. Gjithashtu sipërfaqet e brendshme me lagështi (mure, perde, mobilje) janë vende të përshtatshme për zhvillimin e micelit.

Tabela 65. Përhapja e mikroorganizmave në zonat e ndryshme të Shkollës së Baletit

Zona	**Mikroorganizmat e identifikuar**	**Interpretim kryesor**
Oborri (jashtë)	Fungi imperfecti Cladosporium (me oide të zeza) Oidium	Prezencë e sporeve ambientale që çlirohen nga bimët dhe materiali organik. Cladosporium me oide të zeza tregon rindërtim të sporeve në kushte natyrale. Oidium sinjalizon bimësi pranë murit ose sipërfaqeve të lagura.
Klasa e baletit 1	Makrokonide (p.sh., Aspergillus/Penicillium) Fusarium Fungi imperfecti	Transferim i lartë sporesh saprofitike dhe patogjene nga jashtë: Fusarium dhe Fungi imperfecti mund të kolonizojnë sipërfaqe të ftohta dhe të lagëta të korridoreve. Makrokonidet tregojnë prani spore të lehta me prejardhje nga toka dhe plehrat.
Klasa 2	Oidium (micel i bardhë)	Prania e micelit të bardhë të Oidium brenda klasave tregon që sporet janë vendosur dhe kanë filluar të zhvillohen në sipërfaqe të brendshme me lagështi të lartë.

Tabela 66 paraqet rezultatet e monitorimit të ngarkesave totale mikrobike dhe ngarkesave specifike mykotike në Shkollën e Baletit, duke analizuar mostrat e marra nga korridoret dhe oborret dhe klasa të ndryshme (klasë baleti/e zakonshme) në mediat PCA dhe CAPEK. Konstatohet se ngarkesa bakteriale më e lartë është në oborr, më e ulët në klasën 2. Oborri ka ~5.1 herë më shumë baktere se Klasa 2. Klasa 1 ka ~2.5 herë më shumë baktere se Klasa 2. Ndërkohë, ngarkesa mykore është më e lartë në oborr e më e ulët në klasën 2. Oborri ka më shumë spore se Klasa 2 dhe Klasa 1 ka ~3.0 herë më shumë spore se Klasa 2. Klasa 1 ka më shumë myqe sesa Oborri, që tregon një përqendrim relativ të myqeve brenda ambientit të brendshëm (ndoshta për shkak të lagështisë së palestrës). Klasa 2 ka raportin më të ulët, që tregon mjedis më të thatë ose më mirë të filtruar.


Tabela 66. Ngarkesa mikrobiale në dy terrenet e përdorura për cilësinë e ajrit në shkollën e Baletit

Vendi i marjes se mostres	**Nr.kolonive (PCA-baktere totale aerobe)**	**CFU /m 3**	**Nr.kolonive ne pjaten e Petrit me Capek**	**CFU/m3**	**Raporti mikrobiale^Myqe:ngarkesë (%)**
OBORR	128	5644	12	529	9.38 %
KLASA 1 (klasa e baletit)	62	2734	6	265	9.69 %
KLASA 2	25	1102	2	88	7.99 %

Figura 40 tregon se **oborri** është burim kryesor i sporeve dhe bakterive, për shkak të bimësisë, tokës dhe trafikut të lartë të njerëzve, të cilët sjellin ngarkesë të lartë mikrobiologjike. Klasa 1 (balet) paraqet një raport të lartë myqe/baktere e mund të lidhet me lagështinë e palestrës (djersë, parket druri) dhe ventilim të pamjaftueshëm gjatë orëve intensive. Klasa 2 ka nivelet më të ulëta absolute dhe raport më të vogël myqe/baktere çka tregojnëpër një mjedis më të thatë dhe/ose me më shumë pastrim/filtrim.

Nxënësit e veçantë tek Klasa 1 mund të jenë më të prekur nga simptomat alergjike (teshtima, kollë, acarim sysh) nëse ventilimi nuk përmirësohet. Rezultatet rekomandojnë ajrimi i klasave dhe korridoreve çdo ditë, veçanërisht pasditeve kur niveli i lagështisë bie, si dhe kontroll i lagështisë, të bëhet pastrim dhe dezinfektim me solucione antimykotike (p.sh. pentaklorofenol) etj.

Figura 40. Krahasimi i ngarkesës bakteriale dhe mykotike në ambiente të ndryshme të Shkollës së Baletit.



Figurat 41 dhe 42 paraqesin pamjet e ngarkesave mikrobike në terren PCA dhe CAPEK për ambientet e ndryshme të Shkollës së Baletit. Oborri mbetet burimi kryesor i ngarkesës mikrobiologjike, por Klasa 1 (balet) ka raport të lartë fungi:baktere që kërkon veprime për ventilim dhe kontroll të lagështisë. Klasa 2 paraqet nivel më të ulët ngarkese, por pastrimi dhe monitorimi duhet të vazhdojë në të gjitha zonat.

Figura 41. Pamje e ngarkeses mikrobiale ne terren PCA. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase, Shkolla e Baletit





Figura 42. Pamje e ngarkesës mikrobiale në terren Capek. Nga e majta ne te djathtë Oborr, Korridor dhe Klase, Shkolla e Baletit



Rekomandohet ajrosje çdo ditë: 5–10 minuta para dhe pas orarit. Në balet duhet të hapen dyer/dritare pas çdo seance për të nxjerrë avujt dhe sporet. Lagështa relative duhet të mbahet nën 50 % në palestrën e baletit me dehumidifikatorë. Pastrim i dyshemesë të drurit me detergjent që pengon rritjen e micelit. Mund të përdoren dhe solucione antimykotike.

Në shkollat në vijim janë bërë matjet ekperimentale mirobike vetëm në ambjentet e jashtme, oborre. Të dhënat e mbledhura nga matjet në terren për këto shkolla jane paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën 67.

Tabela 67. Për shkollat e mëposhtme në Tiranë u mat ngarkesa mikrobike vetëm në oborre.

Shkolla	**Nr. kolonive (PCA)**	**PCA (CFU/m³)**	**Nr. kolonive (Capek)**	**Capek (CFU/m³)**
SHKOLLA 100 VJETORI (KAMËZ)	4	176	0	0
SHKOLLA JASHAR HOXHA (PASKUQAN)	12	529	6	264
SHKOLLA SKËNDER LUARASI (LAPRAK)	6	264	5	220
SHKOLLA AHMED GASHI	8	352	4	176
SHKOLLA LIDHJA E PRIZRENIT (PASKUQAN)	5	220	5	220
SHKOLLA E KUQE	236	8 845	16	705
SHKOLLA SKËNDER ÇAÇI	68	2 998	5	220
SHKOLLA ARDIAN KLOSI	226	9 964	17	750
SHKOLLA UDHA E SHKRONJAVE	0	0	12	529
SHKOLLA HASAN TAHSIN	57	2 513	4	176
SHKOLLA MURAT TOPTANI	127	5 600	10	441

Të dhënat tregojnë se “Shkolla Ardian Klosi” dhe “Shkolla e Kuqe” kanë ngarkesat më të larta bakteriale. Në këtë dyshe gjithashtu identifikohen nivele të larta fungale duke sinjalizuar rreziqe

më të mëdha për cilësinë e ajrit jashtë. Në nivelin tjetër, “Shkolla 100 Vjetori” dhe “Shkolla Udha e Shkronjave” nuk shfaqin rritje koloniale PCA. Raporti më i lartë në terma relative shihet te “Shkolla Udha e Shkronjave” (dominim absolut mykor) dhe “Shkolla Jashar Hoxha”. Këto shkolla kërkojnë vëmendje për kontroll të lagështisë dhe parandalim të ndotjes nga myqet.

Shumica e shkollave mbeten me dominim bakterial (raporte <<0.30), por kur PCA kalon 5 000 CFU/m³, edhe Capek shpesh tejkalon pragun 500 CFU/m³ është situatë për t’u shqetësuar. Vecojme situatat e meposhtme në oborret e shkollave:

- Shkolla e Kuqe, Ardian Klosi, Murat Toptani, ku rekombandojmë inspektim filtrimi/ventilim, pastrim intensiv.
- Shkolla e Kuqe, Ardian Klosi, Udha e Shkronjave , ku rekomandojmë matje të lagështisë, trajtim antimykotik sipas nevojës.

Tabela 68 përmbledh matjet e ngarkesave mikrobike dhe mykotike si dhe raportin myqe/ngarkesë mikrobike në të gjitha këto shkolla.

Tabela 68. Permbajtja mikrobike në oborret e shkollave në Tiranë

Shkolla	**PCA (CFU/m³)**	**Capek (CFU/m³)**	**Raporti Myqe/ngarkesë mikrobiale (%)**
SHKOLLA 100 VJETORI (Kamëz)	176	0	0.00
SHKOLLA JASHAR HOXHA (Paskuqan)	529	264	49.91
SHKOLLA SKËNDER LUARASI (Laprak)	264	220	83.33
SHKOLLA AHMED GASHI	352	176	50.00
SHKOLLA LIDHJA E PRIZRENIT (Paskuqan)	220	220	100.00
SHKOLLA E KUQE	8 845	705	7.97
SHKOLLA SKËNDER ÇAÇI	2 998	220	7.34
SHKOLLA ARDIAN KLOSI	9 964	750	7.53
SHKOLLA UDHA E SHKRONJAVE	0	529	—
SHKOLLA HASAN TAHSIN	2 513	176	7.00
SHKOLLA MURAT TOPTANI	5 600	441	7.88
SHKOLLA KOSOVA	4 056	573	14.10
SHKOLLA 7 MARS I	3 880	220	5.67
SHKOLLA E BALETIT	5 644	529	9.38

Duke qenë se nuk ishin shumë të dhëna u bë një parashikim i thjeshtë, për të cilin u përdor një model proporcional linear bazuar tek mesatarja e raporteve myqe:baktere të matur në “Shkolla e Baletit”. Procedura e përdorur është referuar literaturës [7, 8, 9] dhe rezultatet e përftuara janë paraqitur në tabelën 69 . Kjo qasje na lejon të parashikojme ngarkesën në “Korridor” dhe “Klasa”,

si dhe marrëdhëniet që modeli supozon mes vlerave të oborrit dhe atyre indoor. Për matje më të sakta, sugjerohet të mblidhen të dhëna nga çdo shkollë dhe të rregullohet modeli me regresion ose metoda më të avancuara.








Tabela 69. Ngarkesa e baktereve dhe myqeve në oborr, korridore dhe klasa.(parashikim)





Shkolla	Baktere aerobe në Oborr	Myqe në Oborr	Pred. Bakt Korridor	Pred. Myqe Korridor	Pred. Bakt Klasë	Pred. Myqe Klasë
SHKOLLA 100 VJETORI (Kamëz)	176	0	184.8	0.0	94.6	0.0
SHKOLLA JASHAR HOXHA (Paskuqan)	529	264	555.5	146.1	284.3	78.1
SHKOLLA SKËNDER LUARASI (Laprak)	264	220	277.2	121.8	141.9	65.1
SHKOLLA AHMED GASHI	352	176	369.6	97.4	189.2	52.1
SHKOLLA LIDHJA E PRIZRENIT (Paskuqan)	220	220	231.0	121.8	118.3	65.1
SHKOLLA E KUQE	8 845	705	9 287.3	390.2	4 754.4	208.5
SHKOLLA SKËNDER ÇAÇI	2 998	220	3 147.9	121.8	1 611.9	65.1
SHKOLLA ARDIAN KLOSI	9 964	750	10 462.2	415.1	5 353.5	221.9
SHKOLLA UDHA E SHKRONJAVE	0	529	0.0	292.6	0.0	156.5
SHKOLLA HASAN TAHSIN	2 513	176	2 638.7	97.4	1 351.6	52.1
SHKOLLA MURAT TOPTANI	5 600	441	5 880.0	244.3	3 010.0	130.5



Figura 43 paraqet një përmbledhje të ngarkesave mikrobike e mikroflorës së ajrit në oborret e shkollave të ndryshme të Tiranës, në terrene PCA dh CAPEK.

Figura 43. Foto nga mikroflora e ajrit outdoor (oborre) në shkolla të ndryshme të Tiranës.

Oborri i shkollës	Mikroorganizma të identifikuara	Foto PCA	FOTO CAPEK

ARDIAN KLOSI	*Pseudomonas,* *Flavobacterium,* *Actinomycetes,* *Baktere fijëzore*		
HASAN TAHSIN	*Pseudomonas,* *Micrococcus,* *Aeromonas*		
MURAT TOPTANI	*Bacillus Spp,* *Staphylococcus*		
SKËNDER ÇAÇI	*Micrococcus,* *Staphylococcus,* *Bacillus*		

SHKOLLA E KUQE	*Pseudomonas,* *Micrococcus,* *Bacillus Spp*		
LIDHJA E PRIZRENIT	*Aspergillus, Fungi Imperfekti, Cladosporium*		
SKËNDER LUARASI	*Alternaria*		
JASHAR HOXHA	*Actinomycete,* *Micrococcus*		

AHMED GASHI	Penicillium		

Rreziqet kryesore për nxënësit dhe ambientin indoor lidhen kryesisht me sporet mykore (*Aspergillus, Cladosporium, Alternaria*) të cilat mund të hyjnë në klasat përmes ajrit dhe të shkaktojnë probleme alergjike, astmatike dhe sëmundje respiratore. Bakteret patogjene oportuniste si *Pseudomonas, Staphylococcus, dhe Aeromonas* përbëjnë rrezik për fëmijët me imunitet të kompromet uar ose lëndime. Actinomycetet dhe sporet e tokës përkeqësojnë cilësinë e ajrit të brendshëm duke u aerosolizuar dhe duke ngarkuar ajrin me bioaerosole.

Cilësia mikrobiologjike e ajrit në shkolla është një faktor kritik për shëndetin e nxënësve, veçanërisht në ambientet ku fëmijët kalojnë orë të tëra në kontakt të drejtpërdrejtë me ajrin që frymojnë. Dy organizata të rëndësishme që ofrojnë standarde në këtë fushë janë WHO (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe ECA (European Collaborative Action). WHO përcakton udhëzime ndërkombëtare për ndotjen mikrobiale, duke theksuar se nivelet e larta të baktereve dhe myqeve në ajër mund të çojnë në probleme respiratore, alergji dhe sëmundje infektive. Nga ana tjetër, ECA është një grup ekspertësh të mbështetur nga Komisioni Evropian që merret me analizën e ndotjes biologjike në ambientet indoor dhe outdoor. Në raportin e saj nr. 12, ECA sugjeron kufijtë e pranueshëm për mikroorganizmat në ajër: ≤ 500 CFU/m³ për baktere dhe ≤ 100 CFU/m³ për myqe në ambientet e jashtme (oborre shkollash). Në rast se këta kufij tejkalohen, ka rrezik që mikroorganizmat të përhapen edhe në ambiente të brendshme përmes ventilimit apo ekspozimit të drejtpërdrejtë. Prandaj, matja dhe krahasimi i vlerave reale me këto standarde janë thelbësore për të garantuar një ambient të sigurt për fëmijët.

Figura 44 paraqet vlerësimin e riskut mikrobiologjik në oborret e shkollave, bazuar në numrin e mikroorganizmave dhe mikroorganizmat e identifikuara në çdo rast. Ky grafik sinjalizimi tregon nivelin total të riskut mikrobiologjik për secilën shkollë në një shkallë nga 0 deri në 4, bazuar në

ngarkesën bakteriale (PCA) dhe ngarkesën e myqeve (Capek). Ngjyra jeshile sinjalizon një risk të ulët (0 – 1 pikë), ngjyra e verdhë sinjalizon rrezik mesatar (2 pikë) dhe ngjyra e kuqe sinjalizon rrezik të lartë (3 – 4 pikë).

Figura 44. Sinjalizimi i riskut mikrobiologjik në ajrin outdoor të shkollave




Tabela 70 paraqet ngarkesën mikrobike dhe mykore të ajrit në disa shkolla të **Kavajës,** duke u fokusuar në numrin e kolonive bakteriale dhe fungale të shprehura si CFU (Colony Forming Units). Rezultatet e paraqitura më poshtë bazohen në numrin e kolonive të zhvilluara në pllaka ushqyese, të konsideruara si CFU/plate për qëllime krahasimore dhe tregojnë variacione në ngarkesën mikrobiale ndërmjet shkollave të analizuara. Prania e myqeve të gjinisë *Aspergillus* dhe *Candida* tregon nevojën për monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit dhe përmirësim të kushteve të ventilimit në ambientet shkollore.


Tabela 70. Vlerësimi mikrobiologjik i ajrit në oborret e shkollave Kavajë

Shkolla	Baktere CFU/plate	Baktere CFU/m³	Ngjyra e kolonive bakteriale	Myqe CFU/plate	Myqe CFU/m³	Aspergillus niger CFU/plate	Candida mycoderma CFU/plate
Shkolla 17 Shkurti, Qesara	75	3930	E bardhë dhe portokalli	3	157	2	1
Shkolla Riza Lekaj	90	4716	E bardhë dhe portokalli	6	314	4	2

(Hajdaraj, Kavajë)							
Shkolla Luz i Vogël, Kavajë	110	5764	E bardhë dhe portokalli	3	157	2	1

Analiza morfologjike e pjatave të Petrit të ekspozuara në oborret e shkollave tregon një prani të kombinuar të mikroorganizmave bakterialë dhe fungorë, tipike për ajrin ambiental të jashtëm (Figura 45). Vërehet dominim i kolonive bakteriale pigmentuese me ngjyrë të verdhë, portokalli dhe të bardhë, të karakterizuara nga formë e rregullt dhe sipërfaqe e lëmuar, që lidhen me mikroflorën ajrore dhe aktivitetin njerëzor në ambientet shkollore. Paralelisht, konstatohet prania e myqeve filamentore, kryesisht koloni të errëta dhe të bardha me rritje radiale, karakteristike për gjininë *Aspergillus* dhe maja të tipit *Candida*, të cilat sugjerojnë ndikimin e pluhurit, tokës dhe materialit organik përreth. Në tërësi, shpërndarja dhe tipi i kolonive tregojnë një ngarkesë mikrobiale të moderuar deri të lartë, brenda profileve të pritshme për ambiente të hapura shkollore, duke reflektuar kushtet mikroklimatike dhe burimet natyrore të ndotjes biologjike.

Figura 45. Koloni bakteriale pigmentuese (të verdha, portokalli dhe të bardha)



Gjetjet rekomandojnë monitorim periodik të cilësisë mikrobiologjike të ajrit në oborret dhe ambientet e brendshme të shkollave, veçanërisht në periudha me lagështi të lartë. Të përmirësohet mirëmbajtja e oborreve shkollore (pastrimi i rregullt, largimi i gjetheve dhe materialeve organike) për të reduktuar burimet e myqeve. Sigurimin e një ventilimi të mirë dhe qarkullim natyror të ajrit,

sidomos në zonat pranë klasave dhe hapësirave të përbashkëta. Të rritet ndërgjegjësimi i stafit dhe nxënësve për higjienën ambientale dhe rëndësinë e mbajtjes së mjediseve të pastra.

DISKUTIMI

